

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com




Viti XXIII - Nr. 7343 E shtunë 4 Nëntor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës

Serbia thotë se do të vazhdojë politikën e saj të ecjes ndërmjet Rusisë dhe Perëndimit, duke vënë në rend të parë interesin e saj. Ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić ...
Vijon në faqen 20

"ZERI I AMERIKES"

Serbia ngul këmbë në politikën e "dy karrigeve"


Opinion **i** Ditës

Prej ditësh ka një diskutim të gjerë rreth raportit të kryeministrit Rama me median në Shqipëri. Interesant është se ky raport aspak i këndshëm ...
Vijon në faqen 21

Nga ENVER BYTYÇI

Pyetje 'idiote' apo përgjigje idiote?



Orest Sota: Ja çfarë më lidh mua me ish-ministrin

Policia zbulon dy patentat e Saimir Tahirit në mjetin me 800 mijë euro 'cash'

Ministri i Brendshëm i Italisë: Arrestoni të paprekshmit. Ulen shifrat e kanabizimit. Detajet e takimit me Metën e Bashën

Nga VALENTINA MADANI

Policia e Elbasanit arrestoi para dy ditësh biznesmenin Orest Lefter Sota, ndërsa nga kontrolli në makinën që e drejtonte pa patentë iu gjetën dhe bllokuan 800 mijë euro dhe tri patentat, dy leje ...

Në faqen 2-3

INTERVISTE/ FLET AVOKATI AMERIKAN PER ÇESHTJET E EMIGRACIONIT

"LOTARIA AMERIKANE, E PAMUNDUR TE MBYLLET"

Kieran Both: Trump mund të thotë shumë gjëra, por ligji vendos. Kriteret për t'u shpallur fitues. Statistikat e emigracionit shqiptar ndër vite



(Në foto) Avokati Kieran Both

Në faqen 11

"BLUETOOTH"



Luana, në krizë me partnerin për arsye xhelozie. Këtë vit s'ka "Big Brother"

Suplement

Instituti i Sigurimeve Shoqërore publikon manualin për pagesat vjetore

ISSH: Fermerët, kushtet për të përfituar pension

Kriteret që duhet të plotësojnë të vetëpunësuarit, pagesat sipas zonave

Nga ORNELA MANJANI

Instituti i Sigurimeve Shoqërore publikon manualin për pagesat e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi. Në manual janë përcaktuar kushtet që duhet të përmbushë një person për t'u cilësuar i vetëpunësuar në



bujqësi dhe masën e kontributeve sipas zonave. Kështu, i vetëpunësuarit në bujqësi, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur ...

Në faqen 7

KUSH PERFITON

Ministri Ahmetaj: Rritje pagash me 5% për mësuesit dhe infermierët

Në faqen 6

AKSIDENTI

Kërcënoi prokurorin pas vdekjes së djalit, procedohet 60-vjeçari Buzi

Në faqen 9

DEKRIMINALIZIMI

PD-LSI kundër PS, "shpëtojnë" kryebashkiakun e Mallakastrës

Në faqen 5

DOKUMENTET

Ish-të përndjekurit, lista e përfituesve të dëmshpërblimit të kështit të II

Në faqen 19

KULTIVIMI I KANABISIT RAPORTI

Ministri italian, Marco Minniti: Duhet të godasim të paprekshmit

Lufta antikanabis, 88 parcela në 2017, nga 2086 në vitin 2016

GDF: Janë kryer 53 misione ajrore

Ina Allkanjari

TIRANE

Në Pallatin e Kongre seve u zhvillua dje konferenca mbi raportin përmbyllës të misionit të monitorimit ajror 2017 në luftën antikanabis. Në raportin e publikuar nga Stefano Skrepani, shef i repartit të tretë të Guardia Di Finanza, viti 2017 paraqet një reduktim të dukshëm të kultivimit të kanabisit në krahasim me 2016-ën. Të dhënat e siguruar nga raporti i monitorimit për vitin 2017 dhe nga tabela krahasuese me monitorimet e viteve të kaluara tregojnë se janë evidentuar 4 844 rrënjë të kultivuara gjatë 2017-ës, në krahasim me 754 mijë të një viti më parë. Gjatë 2017-ës janë evidentuar 88 parcela të mbjella, nga 2086 të 2016-ës. Sipas raportit, sipërfaqja e kultivuar me kanabis për vitin 2017 ka qenë rreth 1.9 ha, kundrejt 219 mijë ha të një viti më parë. "Këtë vit kemi kryer fluturime në 23.77% të territorit shqiptar, në zona me risk ku mund të kultivohej kanabis. Kemi kryer 53 misione ajrore, ose e thënë ndryshe 129 orë fluturimi. Në 2016-ën konstatuan rreth 2 mijë plantacione me më shumë se 700 mijë rrënjë, ndërsa për 2017-ën, pra këtë vit janë konstatuar 88 plantacione me rreth 5 mijë rrënjë. Reduktimi është i dukshëm", tha Stefano Skrepani, shef i repartit 3 të Guardia di Finanza. Bazuar në raportin e GDF, krahas reduktimit të sipërfaqes së kultivimit të lëndëve narkotike nga viti 2016 në 2017, vihat re një rritje e ndjeshme e sasisë së kapur gjatë vijës bregdetare. Komandanti i Guardia di Finanza, Giorgio Toschi, u shpreh se në brigjet italiane gjatë vitit 2017 ishin sekuestruar 33 tonë kanabis, një rritje 116% krahasuar me 2016. "Italia ka dhënë ndihmë e saj në



Ministri i Brendshëm italian, Marco Minniti

Çako



KREU I POLICISË

"Sot prezantojmë rezultate historike në drejtim të çrrënjosjes së fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike. Çdo punonjës policie mori përgjegjësitë e veta për një territor të caktuar. Përmes agjencisë u përpqëm të siguroni informacion nga qytetarët. Bashkëpunimi me palën italiane ka padysim një rëndësi të madhe", u shpreh Çako.

luftën kundër kanabisit në Shqipëri. Guardia di Finanza ka realizuar mbi 129 orë fluturimi nga muaji maj e deri në tetor të këtij viti. Ky bashkëpunim nuk përfundon vetëm në territorin shqiptar, por vijon në detin e Italisë, në pjesën e poshtme të Adriatikut dhe pjesën e sipërme të Jonit", tha Giorgio Toschi, komandanti i përgjithshëm Guardia Di Finanza.

MINISTRI ITALIAN, MARCO MINNITI

Në konferencën e zhvilluar dje në Tiranë, ministri i Brendshëm italian, Marco Minniti, përgëzoi bash-

këpunimin ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë për luftën kundër trafikëve të paligjshme dhe kundër krimit të organizuar. Minniti u shpreh se prej vitit 2013 deri në 2017 ka pasur një rritje progresive të kapacitetit operativ dhe të rezultateve. Gjithashtu, ministri italian tha se sfida mbetet ndëshkimi i të paprekshmeve. "Ne duhet t'i godasim trafikantët, organizatat e mëdha që menaxhojnë trafikët, duhet të godasim të ashtuquajturit të paprekshëm, se në Itali, Evropë nuk ka të paprekshëm", - tha ministri italian, Minniti.

MARRËVESHJA

Ministri i Brendshëm, Xhafaj dhe homologu italian Minniti nënshkruan dje protokollin "Mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh në luftën kundër terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore". Marrëveshja konfirmon vullnetin e përbashkët për të zhvilluar nismat dypalëshe.

MINISTRI XHAFAJ

Gjatë prezantimit të raportit për kanabisin, ministri Xhafaj u shpreh se kanë kaluar shumë pak muaj nga koha kur nën kujdesin personal të kryeministrit Rama, u hartua dhe u miratua Plani i Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit. "Më 27 mars deklarua se 2017 do të ishte fundi i një historie të gjatë të kultivimit të kanabisit. Ne ia dolëm në këtë fazë të parë të këtij procesi. Sot duhet të kujtojmë që më 18 gusht 2014, një helikopter italian që fluturonte në Lazarat u qëllua nga banorë brenda fshatit, ku u plagos një oficer. Në fshat prodhoheshin çdo vit rreth 900 tonë kanabis.

Lazarati ishte fshat i paaksesueshëm. Ishte simbol i bashkëjetesës me krimin. Sot bastionet e krimit i përkasin të shkuarës", - tha Xhafaj.



Gjatë prezantimit të djeshtëm të raportit të monitorimit të Policisë së Shtetit dhe Guardia di Finanza kundër kultivimit të kanabisit

REAGIMI I TAHIRIT, PATENTAT

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, i pyetur nga TV "Klan" në lidhje me dy patentat në emrin e tij të gjetur në makinën e biznesmenit të arrestuar nga policia sot në Elbasan është shprehur se "për momentin nuk mund të flasë për çështjen".




Ilir Meta dhe Marco Minniti

Presidenti pret ministrin e Brendshëm të Italisë

Meta-Minniti: Lufta kundër drogës, të goditen nivelet e larta të krimit

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje, në një takim të veçantë, ministrin e Brendshëm të Republikës Italiane, zotin Marco Minniti. Duke vlerësuar partneritetin strategjik mes dy vendeve, Presidenti Meta, u ndal në mënyrë të veçantë në bashkëpunimin e gjatë dhe intensiv për çështjet e sigurisë dhe të luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Të dy bashkëbiseduesit përshëndetën rezultatet konkrete dhe koordinimin efikas mes organeve ligj-zbatuese në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve të drogës dhe ndanë të njëjtin mendim se, në këtë luftë është shumë e rëndësishme që të mos ketë të paprekshëm dhe të goditen nivelet e larta të krimit.

Presidenti Meta, vlerësoi rolin vendimtar të Italisë dhe të Antimafias italiane në luftën kundër krimit të organizuar dhe garantimin e një të ardhme më të sigurt në të dy brigjet e Adriatikut, si dhe theksoi se Shqipëria është sot në një moment shumë të rëndësishëm për ndërtimin e një ekonomie të shëndetshme e të qëndrueshme, larg burimeve kriminale. Ministri i Brendshëm, Minniti e konsideroi të rëndësishëm bashkëpunimin mes agjencive të të dy vendeve dhe shprehu angazhimin e tij për vijimin e mbështetjes italiane në forcimin e fuqisë goditëse kundra trafikëve të drogave, si dhe të kapaciteteve investiguese.



Valentina Madani

Policia e Elbasanit ar-
restoi para dy ditësh
biznesmeni Orest
Lefter Sota, ndërsa nga kont-
rolli në makinën që e drej-
tonte pa patentë iu gjetën
dhe bllokuan 800 mijë euro
dhe tri patenta, dy leje drejti-
mi për mjete lundrues në
emër të Saimir Tahirit dhe e
treta e gruas së ish-minis-
trit, Fatlinda Berisha. Ngjar-
ja u denoncua fillimisht nga
kreu i opozitës Lulzim
Basha, ndërsa policia e El-
basanit reagoi më vonë,
duke konfirmuar ndalimin
e biznesmenit Sota, por pa
përmendur dy patentat. Në
njoftimin e policisë nuk sak-
tësohet as vlera e parave të
gjetura në mjetin e biznes-
menit, por përmendet që
bëhet fjalë për një vlerë të
madhe parash. Sipas policisë
i arrestuari Orest Lefter
Sota 25-vjeçar nga Vlora është
pronar i një firme private në
fushën e betonit, ndërsa ka
deklaruar se shumën do ta
përdorte për likuidimin e
disa faturave. Mësohet se
"Sota pretendonte se paratë
do i çonte në një biznes hek-
uri", por sipas bluve ai nuk
kishte asnjë dokument për
paratë. I ndaluar është nipi
i komandantit të RENEA,
Vasillaq Sota. Gjithashtu,
burimet konfirmojnë se bi-
znesmenit i janë gjetur edhe
dy lejet për drejtim të
mjeteve lundruese në emër
të ish-ministrit, ku Tahiri ka
nivelin 'Skipper' (kapiten).
Në makinë është gjetur edhe
një patentë e tretë, e cila është
e gruas së ish-ministrit
Saimir Tahiri, Fatlinda Ber-
isha. Por policia nuk e ka
publikuar një fakt të tillë në
komunikatën për shtyp të
paktën deri në denoncimin
publik nga ana e Lulzim
Bashës. Orest Sota është pr-
onari i firmës 'Fortis Beton'
ndërsa babai i tij, Lefter Sota
është biznesmen në fushën e
ndërtimit, hekur dhe medi-
as. Orest Sota ka deklaruar
në policinë e Elbasanit se
është mik me shoferin e
Saimir Tahirit dhe se lejet e
drejtimit i kishte marrë har-
ruar në makinën e tij shof-
eri i Tahirit. O.S. deklaroi
se ishte mik me Tahirin dhe
udhëtonin shpesh bashkë.
"Saimir Tahiri me Orestin
e 1 milion dollarëve cash!"
Lexoni mesazhin dhe
shikoni foten e qytetarit
dixhital. sh

**Berisha publikon
fotën e Saimir Tahirit
me biznesmenin e
arrestuar në Elbasan**

Ish- kryeministri Sali
Berisha publikoi dje një
foto të qytetarit dixhital
ku shfaqet biznesmeni O.S
së bashku me ish-minist-
rin Saimir Tahiri. Sipas
mesazhit të qytetarit dixhital
fotaja është bërë në komi-
sariatit numër 6 në Tiranë.
Biznesmeni O.S u ndalua
nga policia në Elbasan në
datë 1 nëntor 2017, pasi nuk
iu bind postbllokut të poli-
cisë. Pas kontrollit, policia
gjeti në mjetin e tij 800 mijë
euro dhe dy dëshmi të aftë-
sisë për leje drejtimit në
emër të ish-ministrit të
Brendshëm Saimir Tahiri.
Biznesmeni O.S, 25 vjeçar
ish- ndaluar më 1 nëntor nga
policia por vetëm sot, ar-
restimi i tij u bë publik nga
kreu i PD-së Lulzim Basha,
i cili akuzoi policinë për
fsheshjen e ngjarjes dhe i
kërkoj prokurorisë të he-
tojë. 25-vjeçari deklaroi në
policinë se paratë i kishte
për likuidimin e faturave
dhe se paratë i kishte për-
doruar për blerje hekur nga
babai i tij dhe se patentat i
kishte marrë në makinën e
tij shoferi i Tahirit. O.S.
deklaroi se ishte mik me
Tahirin dhe udhëtonin shpesh
bashkë. "Saimir Tahiri me
Orestin e 1 milion dollarëve
cash!"
Lexoni mesazhin dhe
shikoni foten e qytetarit
dixhital. sh

"Foto e fundit saja me
Orestin komisarati nr.6.
Kapur me mbi 1 milion dol-
larë kesh në Elbasan dhe
dy patenta të Saimir Tahirit
e që policia e mban të fsheht-
e. Administratori përft-
ues i tenderëve për të pas-
truar paratë e krimt, nuk
justifikon dot burimin e
parave.", -thuhet në mes-
azhin dërguar Berishës.

I ndaluar, kishte dhe një patentë të bashkëshortes së ish-ministrit në makinë

Kapet biznesmeni me 800 mijë euro dhe dy patenta skafi të Tahirit

Sota: Kam mik shoferin e Tahirit, patentat i harroi ai



Faksimile e pasaportave të Saimir Tahirit që u gjetën nga policia

EDI PALOKA

"Kur "drejt" është nisur të të marrë. Patentat e Tahirit që janë dokumente personale i mbante shoferi i Tahirit, i cili i "paskësh harruar" te ky që lëvizte me 800 mijë euro cash në makinë. Makinën ia mbanin Habilajt, patentat ky me 800 - she. Por vini re, detajet e fundit nga ngjarja; një nga patentat është për mjete lundruese. Tahiri ka mohuar disa herë të jetë pronar skafi", - shkruan Paloka në "Fb".

POLICIA

"Gjatë kontrollit të mjetit iu gjetën dhe bllokuan një sasi e madhe eurosh, të cilat do t'i përdorte për likuidimin e faturave, por të pashoqeruar me dokumentin e origjinës. Policia e Elbasanit fton kryetarin e opozitës, të mos përdorë burime anonime lajmi duke çuar në keqinformimin e publikut, por ta gjejë të vërtetën tek faqja zyrtare e Policisë së Shtetit", thuhet në komunikatë

"U kap me 800 mijë euro dhe me 2 patenta të Tahirit"

Akuza e Bashës: Policia e fshehu ngjarjen kriminale

Kreu i PD-së, Lulzim Basha denoncoi dje se shtetasit Orest Sota i janë gjetur në makinë 800 mijë euro dhe dy patenta për drejtim makine, në emër të Saimir Tahirit. Përmes një postimi në "Facebook", Basha deklaroi se në datën 1 nëntor, policia e Elbasanit ka arrestuar një shtetas pasi nuk i ka ndaluar postbllokut të policisë. Pas ndjekjes dhe kontrollit, policia gjeti në automjetet 800 mijë euro si dhe dy dëshmi aftësie për drejtim mjeti në emër të ish-ministrit Saimir Tahiri. Sipas Bashës kjo ngjarje është mbajtur e fshehtë nga policia dhe i kërkon prokurorisë të hetojë dhe të vendosë para përgjegjësisë autoritë. "Burime të sigurta informojnë se: "Me datë 01/11/2017 është arrestuar nga policia e Elbasanit shtetasi O.S, sepse nuk i ka ndaluar postbllokut të policisë. Gjatë kontrollit në automjetin i janë gjetur dhe sekuestruar 800 mijë euro dhe dy dëshmi aftësie për drejtim automjeti në



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

DENONCIMI

"Duke dënuar ashpërsisht fsheshjen e ngjarjes kriminale nga Haki Çako dhe Fatmir Xhafaj me urdhër të Edi Ramës, i kërkoj prokurorisë të hetojë e të mos shmangë nga përgjegjësia autorët dhe urdhëruesit e këtij akti mafioz", -thuhet në statusin e kreut të PD-së .

emër të Saimir Tahirit. Ky rast nuk është bërë publik në njoftimet që bëjnë policia. "Duke dënuar ashpërsisht fsheshjen e kësaj ngjarjeje kriminale nga Haki Çako dhe Fatmir Xhafaj me ur-

dhër të Edi Ramës, i kërkoj prokurorisë të hetojë e të mos shmangë nga përgjegjësia autorët dhe urdhëruesit e këtij akti mafioz", -thuhet në statusin e kreut të PD-së. Po

e Elbasanit. Zyrtarisht, policia njoftoi se: Me datë 02. 11. 2017, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit O.S vjeçar 25, banues në Tiranë, administrator i një subjekti privat sh.p.k pasi më datë 01.11.2017, në rrugën nacio-

nale, në fshatin Balldren, u kap duke drejtuar pa leje drejtimit mjetin "Land Rover" dhe nga kontrolli në mjet iu gjetën e bllokuan një sasi e madhe eurosh, i cili pretendonte se do t'i përdorte për likuidimin e faturave, por të

pa shoqëruara me dokumentin e origjinës. Materialet në ngarkim të këtij shtetasi u referuan në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për veprat penale parashikuar nga nenet 291, 242 e 180 të Kodit

Penal". Policia e Elbasanit fton kryetarin e opozitës, të mos përdorë burime anonime lajmi duke çuar në keqinformimin e publikut, por ta gjejë të vërtetën tek faqja zyrtare e Policisë së Shtetit.

KRYEMINISTRI VIZITA

Kryeministri në Marok, në një panel me homologen serbe për të ardhmen e Evropës

Rama: Njohja e Kosovës lehtësim për Serbinë nga një barrë e së shkuarës

"BE të mos lerë Ballkanin zonë gri, të tjerë mund të fusin duart"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama mori pjesë dje, në edicionin e 10-të të Konferencës së Politikave Botërore të zhvilluar në Marok, kushtuar Qeverisjes Globale. Kryeministri Edi Rama ishte i ftuar në panelin me temë "E ardhmja e Evropës Juglindore", së bashku me kryeministren e Serbisë, Ana Brnabić, ku foli mbi rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe rolin e Shqipërisë, në këtë bashkëpunim, si dhe sfidat e integritit të vendit në BE. Duke sjellë si shembull marrëdhëniet mes dy vendeve Shqipërisë dhe Serbisë, të cilat tashmë janë të normalizuara, kryeministri Rama theksoi se e ardhmja më e mirë për popujt e të dy vendeve, ajo që qeverisja duhet të zgjedhë, është fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi i ndërsjellë në të mirën e përbashkët të qytetarëve. "Ajo që unë shoh si një pasqyrim shumë pozitiv të kësaj, është sesa shumë gjërat po ndryshojnë për sa i përket popullsisë. Është një mënyrë e re e të jetuarit në Ballkan, një mënyrë që është rrënjësisht e shkëputur nga kultura sesi jetonim në të kaluarën.", u shpreh kryeministri. Në kuadrin e perspektivës së bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, kryeministri theksoi ndër të tjera se duke njohur Kosovën, Serbia do të bëjë një hap të madh përpara dhe do të lehtësohet nga barra e së kaluarës. "Kosova është sot një Republikë. Është aty dhe funksionon si një shtet i pavarur, sovran, me institucionet e tij, dhe jam shumë i lumtur ta them, me një model shumë të admirueshëm respekti për minoritetet, para së gjithash për minoritetin serb, i cili ka përfaqësi në parlament, në qeveri. Bindja ime është, ka qenë gjithmonë dhe mbetet që, duke njohur Kosovën, Serbia do të bëjë një hap të madh përpara dhe do të lehtësohet nga një barrë e së kaluarës, e cila është pengesë për të parë drejt së ardhmes më e lehtë-



Kryeministri Edi Rama

ZGJERIMI

"Ky rajon është vendi i duhur për të kuptuar se sa është tërheqëse Europa për njerëz që dinë se çfarë është lufta, që e kanë parë atë dhe e dinë se sa keq gjërat mund të shkojnë prej saj, ndaj rritet edhe një herë faktin që edhe procesi i integritit do të ndihmojë në zbutjen e këtyre pakënaqësive dhe mosmarrëveshjeve", - tha Rama.



Kryeministri Edi Rama dje, në edicionin e 10-të të Konferencës së Politikave Botërore të zhvilluar në Marok, kushtuar Qeverisjes Globale

LSI mbledh të dielën Konventën Kombëtare për aksionin politik

Monika Kryemadhi: Qeveria "Rama", zëri i krimit të organizuar jo e qytetarëve

Lëvizja Socialiste për Integritim do të mbledhë të dielën Konventën Kombëtare të saj. Këtë e vendosi dje, kryesia e kësaj partie, e cila u mbledh nën drejtimin e kryetares Monika Kryemadhi. Në fjalën e saj, Kryemadhi u shpreh se krimi dhe qeverisja tashmë janë bërë një. "E kapur nga krimi mazhoranca e ka kthyer edhe parlamentin në mburojë të krimit dhe parlamentarizmin e ka zëvendësuar me vasalizëm ndaj krimit duke veshur atë me mburojë politike, siç që edhe rasti më i fundit i Sajmir Tahirit, rast i paprecedent në të gjithë rajonin tonë ku një ministër i Brendshëm akuzohet si lidhje e bashkëpunëtor i trafikantëve të drogës. Në çdo vend tjetër normal e demokratik një situatë e tillë do të çonte në dorëheqjen e qeverisë!", deklaroi Kryemadhi. Sipas saj, "të kapur prej krimit Edi Rama dhe shpura e tij e korruptuar nuk kanë rrugë tjetër, veçse ta



hedhin vallen sipas ritmeve që imponon orkestra e krimit!". Duke bërë një analizë të rezultativitetit që LSI arriti në zgjedhjet e 25 qershorit, Kryemadhi tha se me gjithë përpjekjet e qeverisë, LSI ka marrë më shumë vota dhe


PRETIT VASILI

Kryetari i grupit parlamentar të LSI-së u kërkoi dje, dy ambasadorëve të SHBA-së dhe BE-së që të reagojnë, pasi "Reforma në drejtësi u kap nga Rilindja, askush nuk beson më të ajo". "Edhe shqiptarë më i fundit nuk ka harruar se u garantuan publikisht nga ambasadorët Lu dhe Vlahutin, se ligjet e reformës në drejtësi do t'i bënin ekspertët dhe do të vinin për miratim pa ndryshime në parlament", - shkroi Vasil.

vende në Parlament se asnjëherë më parë. "LSI e ka deklaruar vazhdimisht se qeveria e Ramës nuk është qeveria e zërit të njerëzve, por zëri i krimit të organizuar", tha ajo. Ndërkohë pasdite, Kryemadhi ishte në

Gjirokastrë, ku pati një takim me qytetarët atje. Në këtë takim, kryemadhi tha: "Edi Rama zgjodhi të ishte zëri i krimit, ne zgjodhëm të ishim zëri i qytetarëve". "Sot kemi një qeveri që nuk punon, kemi një qeveri që përfaqëson 4 familjet mafioze, siç e ka thënë edhe ambasadori amerikan Lu, përfaqëson klanet kriminale, siç e ka thënë ambasadori Lu, por edhe shumë të tjerë. Të gjitha këto fjalë të LSI-së u vërtetuan me raportin që solli antimagjia italiane", - tha Kryemadhi. "Unë jam e bindur që me kriminelët, me mafiozët, me kryemafiozin Edi Rama, i cili ka marrë peng këtë vend, ka marrë peng shqiptarët dhe shpresën e tyre për ta kthyer në shtëri të krimit të organizuar, është një betejë që do të fitojnë shqiptarët", tha Kryemadhi.

theksoi se është shumë e rëndësishme që vendet e Ballkanit të jenë pjesë e projekti evropian, si një faktor më shumë për një Europë më të sigurt. "Është shumë e rëndësishme të përfundojmë këtë projekt, ekzaktesisht për të



Reforma në drejtësi, emrat e fituesve të KLGJ dhe KLP, kush u skualifikua

Kuvendi i Shqipërisë publikoi dje, emrat e kandidatëve që janë kualifikuar dhe ata që nuk janë kualifikuar për të qenë pjesë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Këshillit të Lartë të Gjyqësorit. Sipas Parlamentit kandidatët që kanë plotësuar kriteret e vendosura dhe që do të jenë pjesë e KLP janë: Mirela Bog-dani, Orjona Muçollari, Eneida Sema, Sandër Beci, Gent Ibrahim. Ndërkohë dy kandidatët që janë skualifikuar pasi nuk kanë përmbushur kriteret janë Darel Sina dhe Eriola Canaj. Po kështu për sa i përket KLGJ kandidatët që janë kualifikuar janë: Mirela Bog-dani, Maksim Qoku, Erjon Muharremaj, Ilir Panda. Kandidatët që nuk kualifikohen për KLGJ janë Brunela Kulloti, Danjel Sina dhe Erlola Canaj

njëjtën arsye që anti-europianët theksojnë, ekzaktesisht për arsyen e sigurisë." Kryeministri u shpreh se Ballkani i sotëm është pozicionuar qartë për BE dhe se po punon fort për këtë perspektivë.



Partia Demokratike do të përshkallëzojë qëndrimin e saj për rastin "Tahiri". Nënkrjetari Edi Paloka konfirmoi dhe se opozita po përgatitet për protesta, qëllimi final i të cilave është rrëzimi i Edi Ramës. "Të gjitha faktet, jo vetëm ato që kemi denoncuar gjatë fushatës apo pas fushatës, por edhe konfirmimet e fundit që vijnë nga Antimafia italiane tregojnë qartazi që vetëm zgjedhje nuk ka pasur në Shqipëri, por ka pasur një aktivitet kriminalo-mafioz, që rezultoi pastaj me rivendosjen e Ramës kryeministër. Kështu që sot jemi në një situatë, që absolutisht duhet ndryshuar", u shpreh Paloka për "News 24". "Nuk ka genie mediokre apo inteligjente në Shqipëri të besojë që gjithçka e ka bërë Saimir Tahiri pa bekimin e Edi Ramës. Për këtë arsye jemi në këtë sit-

Nënkrjetar i PD lajmëron nismë ligjore për imunitetin e deputetëve

PD përgatitet për protesta popullore, Paloka: Qëllimi final, rrëzimi i Ramës



uatë, për këtë arsye PD kërkon rrëzimin e kësaj qeverisë dhe krijimin e një qeverie Antimafia. Sigurisht, nuk presim që Edi Rama ta bëjë me vullnet të tillë, protestat janë një nga

mënyrat që po përgatitim dhe do ta realizojmë. Nuk mund të them afatë të përcaktuara, se është një proces i tërë, që po përgatitim së bashku me opozitën, me qëllim që të ketë rezultat fi-

nal", shprehet Paloka për "BalkanWeb". "E thashë, nuk presim reagim, për këtë arsye synimi ynë është rrëzimi i kësaj qeverie. Funkzionarë të lartë dhe ish-ministra të tjerë janë të implikuar në raste korrupsioni, kjo është çështje tjetër që lidhet me të tjera informacione, me të tjera ngjarje që do vinë më pas", theksoi Paloka. Partia Demokratike po përgatit një nismë ligjore për heqjen e plotë të imunitetit e politikanëve. Numri dy i Partisë Demokratike konfirmon se i gjithë grupi parlamentar është përmishtë dakord, por ekspertët po kujdesen për detajet që një nismë e tillë të mos keqërdoret nga mazhoranca.

Dekriminalizimi, debate për kreun e Bashkisë së Mallakastrës, Agron Kapllanaj

PD-LSI bashkojnë votat kundër PS, KQZ shpëton kryebashkiakun e djathtë

Biba: T'i ndërpritet mandati. Zguri: U rehabilitua

Darina Tanushi

PD dhe LSI bashkuan dhe votat në KQZ për të rrëzuar kërkesën e dy anëtarëve të PS-së në këtë komision për t'i hequr mandatin kryebashkiakut të Mallakastrës, Agron Kapllanaj. Denar Biba dhe Bledar Skënderi, dy anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kanë depozituar në KQZ kërkesën për të hequr mandatin e kryetarit të Bashkisë së Mallakastrës, Agron Kapllanaj, bashki e fituar nga Partia Demokratike. Kërkesa e dy anëtarëve të mbështetur nga Partia Socialiste vjen në kuadër të ligjit të dekriminalizimit dhe dy anëtarët e KQZ pretendojnë se Agron Kapllanaj është dënuar në Itali, në vitin 1995, për veprën penale "vjedhje". Këtë fakt kryebashkiaku i Mallakastrës e ka deklaruar në formularin e dekriminalizimit, kur fitoi mandatin në vitin 2015. Sipas Kodit Penal italian, neni 624, thuhet se, "kushdo që i merr tjetrit sendet me forcë dhe në fund merr përfitimin për vete apo për të tjerët, dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet dhe me gjobë nga 150 euro deri në 516 euro". Por, nga ana



Komisionit Qendror i Zgjedhjeve

tjetër pas debateve dhe tensioneve që shoqëruan këtë mbledhje, anëtarët e PD dhe LSI vlerësuan se për këtë çështje është diskutuar njëherë në 2016-ën, ndërsa KQZ ka mbajtur një qëndrim që mandati nuk duhet t'i hiqet. Sipas atyre çfarë deklaroi edhe kryetari i KQZ-së, Klement Zguri, kjo çështje është diskutuar në 29 korrik 2016, kur kryetar ka qenë Denar Biba dhe është gjykuar se Kapllani nuk prekej nga ligji i dekriminal-

izimit. KQZ votoi me 4 vota kundër dhe 3 pro heqjes së mandatit të kryebashkiakut të Mallakastrës, Kapllanaj. Mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u shoqërua me debate të forta, ku ishte ish-kreu i KQZ, Denar Biba, që kërkoi t'i hiqet mandati kryebashkiakut. Biba u përplas me kreun aktual, Klement Zguri, teksa i ka thënë se nuk bëri mbledhje për rastin e kryebashkiakut të djathtë, edhe pse sipas tij, Prokuroria ka dërguar mate-

rialin dhjetë ditë më parë. Ashtu si Sekretari i Përgjithshëm i PS, Taulant Balla, edhe Biba kërkon t'i ndërpritet mandati Kapllanajt, por kjo është cilësuar si presion politik mbi KQZ nga ana e Zgurit. "Edhe pse ka ardhur materiali nga Prokuroria 10 ditë më parë, kryetari i KQZ nuk bëri mbledhje. U detyruam ne që të thërrisnim mbledhje. Më 16 tetor të këtij viti struktura e posaçme ka kthyer përgjigjen për dënim djathtë mbi Itali", tha Biba, duke kërkuar ndërprerje të mandatit. "Presioni nga politika në drejtim të KQZ është i patolerueshëm. Këtu është fjala për deklaratën e alless, dy orë më parë. Për Kapllanajn, KQZ është shprehur dhe ka pasur një vëmendje të saj. Në atë kohë, edhe tek kjo listë nuk ka pasur asnjë pretendim dhe çështja është mbyllur. Deklarata Bibës është e pahijshme, se unë nuk mbledha KQZ-në për Kapllanajn", sqaroi Zguri. Sipas Zgurit, për rastin e Agron Kapllanajt, Prokuroria ka dërguar një informacion, sipas së cilit, theksohet se vepra për të cilën akuzohet kryebashkiaku i PD është rehabilituar dhe për rrjedhojë nuk çon në heqjen e mandatit.

Shoqëria përbarimorë "AFA-2010" sh.p.k
shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:
Pasurisë me Nr.3/369 e llogjit "Trulli + Banesë 3 katëshe" me sip. truall 350 m2 dhe sip. banese 191.9 m2. (1 katë përthe 191.9 m², katë i 1.269.03 dhe katë i 269 m²) ndodhur në L. "11 Janari", ZK 2310. Kujtohet në pronësi Agim Isa Zeqva. Çmimi fillestar në ankandin e dytë është është 11,200,000 Lekë. Ankandi zhvillohet në datë 09.11.2017, ditën e Enjte ora 15.30 n në ambientet e Shoqërisë Përbarimorë "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë.
Për info. Tel:045593458 ose E-maili shoqeriapërbarimorëafa2010@gmail.com

PS

ERIDIAN SALINJI

Përfaqësuesi i PS-së në KQZ iu drejta dje kreut të komisionit me fjalët: "Ti (Zguri) nuk mund të mbrohesh këtu se je i pavarur. Se ku i je i varur ti, e di vetë. Deklarata që bëri PS duhej bërë shumë ditë më përpara, jo sot. Ti sot e ke vënë në dyshim karrigen që ke. Ti nuk mund ta fshehësh kërkesën. Kjo që ndodhi është përgje-gjësi e juaja. Nëse shkel ligjin, duhet të presësh edhe përgjigjen. Ti erdhe me një marrëveshje politike aty. Ajo ka mbaruar tani dhe besoj që edhe ti je i fundit i mohikanëve".

Taulant Balla: Zgjedhje të reja në Bashkinë e Mallakastrës

Partia Socialiste kërkon zgjedhje të reja për Bashkinë e Mallakastrës, pasi për të, Agron Kapllanaj, kryetari aktual është i ndëshkueshëm sipas ligjit të dekriminalizimit. Sekretari i përgjithshëm i Partisë Socialiste, Taulant Balla në një reagim të tij tha dje se prokuroria "ka mbyllur një sy" për kryebashkiakun, përfaqësues të Partisë Demokratike. "Konstatojmë se në kundërshtim flagrant me ligjin, Prokuroria, ndonëse në vendim e saj e pranon se subjekti deklarues Agron Kapllanaj përfaqësues të fushës e veprimtari të nenit 2, gërma c, të ligjit 138/2015... pasi... me vendim të datës 07.04.2003, i cili ka marrë formë të prerë në datë 17.02.2004, z. Agron Kapllanaj është dënuar me 2 vjet heqje lirie dhe 200 euro gjobë për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes", si përfundim vendos të mbyllë të dy sytë për këtë kryebashkiak përfaqësues të Partisë Demokratike, duke i falur atij qëndrimin në detyrë me arsyetimin se "ndalimi 10-vjeçar i parashikuar nga ligji për dekriminalizimin në lidhje me këtë masë dënimi ka përfunduar tashmë prej 1 viti" (në 16.02.2016). Sipas tij, mandati i Kapllanajt tashmë dukshëm rezultoi të jetë në kushtet e pavlefshmërisë absolute, pasi është subjekt i ndëshkueshëm prej ligjit "Për dekriminalizimin".

Projektbuxheti i vitit 2018, rritja e pensioneve 2 %

PROJEKTBUXHETI

Rritje page me 5 %

- 31 mijë mësues
- 18 mijë mjekë e infermierë
- Pensionet rriten me 2 %

Ornela Manjani

Qeveria ka vendosur të rrisë pagat për vitin e ardhshëm, por jo për të gjithë punonjësit e shtetit. Rritja do të jetë 5 % dhe do t'i nisë efektet financiare në korrik të vitit të ardhshëm. Lajmi u bë i ditur nga ministri i Financave Arben Ahmetaj, i cili zbardhi para deputetëve se cilat kategori do të përfitojnë nga rritja. "Ne kemi menduar në buxhet rritje sektoriale pagash për arsimin dhe shëndetësinë", tha ministri Ahmetaj. Sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Financave, nga rritja e pagave do të përfitojnë 31 mijë mësues në të gjithë vendin si dhe 18 mijë mjekë dhe infermierë. Ndonëse ende nuk është vendosur përfundimisht se kur do të hyjë në fuqi rritja e pagave, varanti paraprak që po diskutohet parashikon që ajo të nisë nga 1 korriku, ndërsa masa e rritjes mendohet se do të jetë rreth 5 për qind.

PENSIONET

Për pensionistët parashikohet që të ketë indeksim, pra një rritje e pensioneve rreth nivelit 2 për qind për të kompensuar rritjen e çmimeve, ndërkohë që për kategoritë e tjera të punonjësve pagat do të mbeten të pandryshuara.

DISKUTIMET

Dje u zhvilluan diskutimet në Komisionin e Ekonomisë mbi projektbuxhetin e 2018 pa praninë e opozitës. Kjo e fundit, ka braktisur këtë seancë të sotme, duke argumentuar se nuk do të jenë pjesë e diskutimeve. Relatori i projektbuxhetit, Anastas Angjeli ka nisur fjalën e tij duke treguar tri karakteristika kryesore. "Për cakton politikat dhe treguesit e vitit të ardhshëm. Karakteristikat mbështesin konsolidimin fiskal. Synojmë hapjen e negociatave, bashkëpunimi ka qenë i nevojshëm. Ka pasur zhvillim pozitiv edhe gjatë vitit të kaluar. Ky buxhet është i konsoliduar në periudhë afatmesme. Rritja ekono-

Ahmetaj: Pagat rriten 5%, përfitojnë mësuesit, mjekët dhe infermierët

Rreth 49 mijë arsimtarë e mjek përfitojnë rritje rroge



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

Të ardhurat nga tatimet dhe doganat, që do të sjellin 63% të totalit të buxhetit, pritet të rriten me 5.9% (17.8 miliardë lekë), duke arritur në 317.2 miliardë lekë. TVSH-ja si gjithmonë, do të mbajë peshën kryesore në të ardhurat nga tatimet e doganat, duke siguruar 47.5% të tyre. Në vlerë absolute, të ardhurat nga tatimi i vlerës së shtuar pritet të arrijnë në 150.7 miliardë lekë, me një zgjerrim vjetor prej 6.8% në

Të ardhurat në buxhet nga tatimet e doganat

raport me pritishtësinë e këtij viti. Qeveria ka në plan që këtë vit të zgjerojë skemën e TVSH-së edhe te biznesi i vogël. Megjithatë, në buxhet, plani për TVSH-në mbetet në 9.1% të PBB-së, njësoj si në vitin 2017. Sipas draftit të ardhurat nga tatimi fitimi do të arrijnë në 33.4 miliardë lekë, me një pritishtësi për një zgjerim të ndjeshëm prej 14.4% me bazë vjetore. Ndërkohë nga akci-

za pritet të grumbullohen 50.4 miliardë lekë, me një rritje me bazë vjetore prej 7.9% në raport me pritishtësinë e 2017-s. Tatimi mbi të ardhurat personale pritet me një rritje modeste prej 3%, për të arritur në 37.3 miliardë lekë. Qeveria ka bërë publik planin për të ulur tatimin mbi pagat e larta nga 23% në 18%, por deri tani nuk ka sinjale se kjo do të ndodhë brenda vitit 2018.

mike mbështetur mbi konsum dhe investime. Këtë vit investimet publike do të mbështesin rritjen", ka deklaruar Angjeli. Karakteristikë tjetër, sipas tij, do të jetë

mbështetja përmes buxhetit, për reformat në sektorin e ujit, drejtësisë, administratën publike, turizëm, infrastrukturë, bujqësi, dixhitalizim etj. Në fjalën e saj,

deputetja Evis Kushi thekson se paketa reflekton angazhimin e qeverisë. Paketa fiskale paraqet politikat që do ndiqen gjatë vitit 2018, përzgjerimin e të ardhurave dhe

Të ardhurat për frymë do të rriten me 32 mijë lekë

Ministri i Financave, gjatë diskutimeve për buxhetin në Komisionin e Ekonomisë ka folur se sa do të rriten të ardhurat për frymë gjatë vitit 2018, ku ka bërë edhe një krahasim me vitin 2017. Sipas ministrit Ahmetaj, të ardhurat për frymë ndryshojnë me rritjen ekonomike të vendit. "Të ardhurat për frymë rriten përmes rritjes ekonomike dhe konkretisht të ardhurat për frymë për vitin 2017 janë në 540 mijë lekë, ndërkohë që në vitin 2018 të ardhurat për frymë pritet të arrijnë në 572 mijë lekë." Ahmetaj foli edhe një herë gjatë këtij takimi në lidhje me taksën e pronës ku shpreh se kjo taksë është trajtuar për metër katrorë dhe se Shqipëria ka taksën më të ulët në rajon për pronën. "Në Shqipëri niveli i taksës është 0.05 për qind për individin dhe 0.15 për qind për korporatat." Gjithashtu, ministri foli edhe për bypasin e Fierit, ku sipas tij projekti është në proces ritenderimi. Gjatë diskutimeve në Komisionin e Ekonomisë ministri iu përgjigj pyetjeve të deputetëve, ku theksoi edhe një herë se do të përjashtohen nga pagesa e TVSH investimet mbi 50 mln lekë.

përmirësimin e klimës së biznesit. Kreu i Financave shqiptare Ahmetaj iu përgjigj pyetjeve nga Haxhinasto për konkurrueshmërinë me rajonin për taksat. "Për sa i përket kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, jemi të dytë me kosto më të ulët. Kosova e ka më pak se ne", tha ministri. Nga ana tjetër, ai tregoi se sistemi i tatimit mbi të ardhurat ndjek një politikë sociale, shoqëruar me taksimin progresiv. "Jemi të vetmin në rajon që nuk taksojmë një fashë të gjërë të punësuarish", tha ai. "Buxheti i vitit 2018 është një buxheti i parë i mandatit tonë të dytë në qeveri. Është

buxheti që nga njëra anë, materializon arritjet kryesore të katër vjeçarit të parë, dhe nga ana tjetër reflekton objektivat tona kryesore në programin ekonomik 2017-2020 me një fokus të veçantë vazhdimin e rritjes ekonomike dhe investimeve publike, rritjes së të ardhurave, mbështetjes së reformave, uljes së borxhit dhe vazhdimin të konsolidimit fiskal". - u shpreh Ahmetaj gjatë prezantimit të projektbuxhetit duke shtuar se shtyllat kryesore, në të cilat është konceptuar buxheti për vitin 2018: janë rritja ekonomike e lartë dhe vazhdimi i uljes së borxhit publik.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "**Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe sigurancioni i shëndetit në udhëtim i punonjësve të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare**".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 23,694,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Sigurimi i jetës, kujdesit shëndetësor dhe sigurancioni i shëndetit në udhëtim i punonjësve të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare**".

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **24 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
 SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "**Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë**".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,970,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
 BIC: STANALTR
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "**Blerje e një pajisje pirun elektrik, për nevojat e Bankës së Shqipërisë**".

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **30 Nëntor 2017, ora 14:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Të vetëpunësuarit duhet të paguajnë nga 29 400 deri 38 400 lekë në vit

Ornela Manjani

Instituti i Sigurimeve Shoqërore publikon manualin për pagesat e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi. Në manual janë përcaktuar kushtet që duhet të përmbushë një person për t'u cilësuar i vetëpunësuar në bujqësi dhe masën e kontributeve sipas zonave. Kështu, i vetëpunësuarit në bujqësi, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh. Sipas manualit, i vetëpunësuarit në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim paguan kontributet për sigurimet shoqërore kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh.

SI TË PËRFITONI NGA SKEMA

Personat që nuk kanë asnjë vit të mbuluar nga sigurimet, për shkak se s'kanë punuar ose gjatë kohës që kanë punuar kanë qenë të pasiguarit kanë shans për të marrë pension pleqërie. Ata mund të përfitojnë nga dy vendime qeverie, VKM nr. 77, datë 28.01.2015 dhe në VKM nr. 653, datë 22.07.2015. Qytetarët e interesuar mund të sigurohen si të vetëpunësuar në bujqësi, por duhet të plotësojë dy kushte. E para, duhet të kenë tokë bujqësore dhe të banojnë në të njëjtin rreth ku ndodhet toka në pronësi ose në përdorim dhe të zhvillojnë veprimtari bujqësore e blegtorale. E dyta, personi duhet të banojë në fshat dhe zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale, edhe nëse ka tokë në pronësi ose në përdorim, me vendndodhje në rrethin fqinj.

ISSH, manual për sigurimin e fermerëve, kontributet dhe përfitimet për çdo zonë

Kushtet që duhen plotësuar për të marrë pension



PROCEDURAT

I vetëpunësuarit në bujqësi paraqet tek inspektori i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi të sigurimeve shoqërore këto dokumente: certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile; vërtetimin e pronësisë mbi tokën, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme të komunës ose bashkisë ose akt noterial, që vërteton tjetërsimin e pronës (p.sh, qiramarrje).

në zyrën postare ose në zyrën bankare. Me kryerjen e pagesës, zyra postare lëshon dokumentin "Mandat arkëtimi", ndërsa me kryerjen e pagesës në zyrën bankare lëshohet dokumenti "Veprim arke", i cili konfirmon kryerjen e kësaj pagese. Me dokumentin "Mandat arkëtimi" ose "Veprim arke", personi paraqitet për regjistrim tek inspektori i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, ku ka marrë "Urdhër veprimin". Këto dokumente në asnjë rast nuk duhet t'u dorëzohen punonjësve të sigurimeve shoqërore. Ato janë personale. Në fund të procedurës dhe pas pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, bëhet pajisja e detyrueshme me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

tokën bujqësore në pronësi ose në përdorim dhe të zhvillojë veprimtari bujqësore e blegtorale dhe të banojë në fshat, megjithëse tokën mund ta ketë në nënqarkun fqinj.

DOKUMENTET

I vetëpunësuarit në bujqësi paraqet tek inspektori i sig-

urimit të të vetëpunësuarve në bujqësi të sigurimeve shoqërore këto dokumente: certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile; vërtetimin e pronësisë mbi tokën, lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme të komunës ose

bashkisë ose akt noterial, që vërteton tjetërsimin e pronës (p.sh, qiramarrje). Sipas ligjit në çdo rast, për sigurim të periudhave për vitin korrent si dhe për periudha të kaluara, do të paraqitet vërtetimi i lëshuar nga komuna, ku cilësohet se personi ushtron ve-

primtari, bujqësore/blegtorale. Inspektori i të vetëpunësuarve në bujqësi, pasi gjykon për plotësimin e kushteve për sigurim si i/e vetëpunësuar në bujqësi, plotëson dokumentin tip "Urdhër veprim". Për të bërë pagesën paraqitet ky dokument

SIGURIMI I FERMERËVE

I. Kushtet për t'u siguruar.

Mbështetur në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe në VKM nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", të ndryshuar personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë këto kushte:

1. Të ketë mbushur moshën 16 vjeç.
2. Të jetë i/e aftë për punë.
3. Çdo person mund të sigurohet deri në mbushjen e moshës për pension.
4. Nuk duhet të jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë.

II. Pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore

1. Sigurimi si i/e vetëpunësuar në bujqësi është i detyrueshëm.
2. I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi, që banon në zonat fushore, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 38 400 lekësh.
3. I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi, që banon në zonat malore, nga data 01.08.2015 e në vazhdim, paguan kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 29 400 lekësh.
4. Pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore bëhen bashkërisht. Ato janë të detyrueshme dhe paguhen individualisht një herë në tre muaj.
5. Afati i fundit i këtyre pagesave është jo më vonë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo tremujori kalendarak.
6. Të vetëpunësuarit në bujqësi paguajnë kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, për vitin në vazhdim, pavarësisht nëse janë të pasiguarit për vitet pararendëse. Periudhat, për të cilat nuk janë paguar kontributet nuk njihen si periudha sigurimi.
7. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kushtin minimal të vjetërsisë në punë për të përfituar pension të pjesshëm, sipas dispozitave të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, mund të kryejnë pagesa kontributesh pas plotësimit të moshës për pension, por me kusht që ato t'u korrespondojnë periudhave para plotësimit të moshës për pension dhe të mos jetë caktuar ende asnjë lloj pensioni dhe për këto periudha do të paguhet sipas masës së kontributit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.
8. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të cilët nuk i kanë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhat e kaluara, por që i kanë pasur kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, pavarësisht nga vendbanimi aktual, mund t'i paguajnë kontributet për këto periudha sipas masës së kontributit, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për vitin kur kryhet pagesa.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore

KUSHTET PËR TË SIGURUAR

Sipas ligjit për sigurimet shoqërore, personi që futet në skemën e detyruar të sigurimit shoqëror për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi, duhet të plotësojë këto kushte: të ketë mbushur moshën 16 vjeç, të jetë i/e aftë për punë, çdo person mund të sigurohet deri në mbushjen e moshës për pension, nuk duhet të jetë i siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë. Sipas ligjit, i vetëpunësuarit në bujqësi duhet të banojë në të njëjtin nënqark ku ka

MANUAL PËR KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE 3

III. Përfitimet që rrjedhin nga skema e detyrueshme e sigurimeve shoqërore për të vetëpunësuarit në bujqësi.

1. Kuotat e ulëta të pagesave të kontributeve për sigurimin shoqëror, si rrjedhojë e politikave favorizuese shtetërore.
- Për një vit vjetërsie në punë në shtet një i/e vetëpunësuar në qytet paguan 66 240 lekë, ndërsa:
 - a) I/e vetëpunësuarit/a në zonat fushore paguan 38 400 lekë në vit.
 - b) I/e vetëpunësuarit/a në zonat malore paguan vetëm 29 400 lekë në vit.
2. Përfitim të vjetërsisë në punë, ku njohja e periudhave për të cilat janë paguar kontributet njihet vjetërsi në marrëdhënie pune me shtetin.
3. I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, është përfitues/e, sipas rasis, i/e:
 - Pensionit bazë të pleqërisë.
 - Pensionit të pjesshëm të pleqërisë.
 - Pensionit të invaliditetit.
 - Pensionit të pjesshëm të invaliditetit.
 - Pensionit familjar.
 - Shpërblimin për lindje fëmijë.

IV. Dokumentacioni e procedurat për t'u siguruar si i/e vetëpunësuar në bujqësi.

1. I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi paraqet tek inspektori përkatës i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi këto dokumente:
 - Vërtetimin e pronësisë mbi tokën, lëshuar nga zyra e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, pranë organeve të pushtetit vendor dhe/ose vërtetimin mbi tokën e marrë në përdorim, lëshuar nga strukturat përkatëse, pranë organeve të pushtetit vendor dhe/ose kontratën e qiramarrjes së tokës bujqësore, të noterizuar.
 - Në çdo rast, për sigurim të periudhave për vitin korrent si dhe për periudha të kaluara, do të paraqitet vërtetimi i lëshuar nga komuna, ku cilësohet se personi ushtron veprimtari, bujqësore/blegtorale.
2. Inspektori i të vetëpunësuarve në bujqësi, pasi gjykon për plotësimin e kushteve për sigurim si i/e vetëpunësuar në bujqësi, plotëson dokumentin tip "Urdhër veprim" dhe ia jep fermerit.
3. Për të bërë pagesën paraqitet ky dokument në zyrën postare ose në zyrën bankare. Me kryerjen e pagesës, zyra postare lëshon dokumentin "Mandat arkëtimi", ndërsa me kryerjen e pagesës në zyrën bankare lëshohet dokumenti "Veprim arke", i cili konfirmon kryerjen e kësaj pagese.
4. Me dokumentin "Mandat arkëtimi" ose "Veprim arke" fermeri paraqitet për regjistrim tek inspektori i sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi, ku ka marrë "Urdhër veprimin".
5. Këto dokumente në asnjë rast nuk duhet t'u dorëzohen punonjësve të sigurimeve shoqërore. Ato janë personale.
6. Në fund të procedurës dhe pas pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, bëhet pajisja e detyrueshme me librezën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
7. Me kërkesën e të vetëpunësuarit në bujqësi, ai pajiset nga organet e sigurimeve shoqërore edhe me vërtetimin tip "Për pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore".

Mediat e vendit fqinj: Bastisjet e shtëpive bëheshin në prani të familjarëve

Shkatërrohet banda që grabiste banesa, në pranga 6 shqiptarë

Dy prej tyre, familjarë të Vasil Ramës, që terrorizoi banorët e Italisë së Veriut me "Audi"-n e verdhë

ITALI

Policia e Padovës në Itali ka shkatërruar një bandë kriminale, e cila ishte përfshirë në bastisjen e banesave. Mësohet se 6 shqiptarë që merreshin kryesisht me grabitjen e shtëpive (në prani të familjarëve) janë vënë në pranga, ndërsa dy prej tyre janë familjarë të Vasil Ramës, shqiptarët që terrorizoi Italinë me "Audi"-n e verdhë afro një vit më parë. Sipas "Corriere Della Sera", shqiptarët e arrestuar kanë vjedhur qindra shtëpi në Italinë e Veriut dhe në momentin që janë kapur ishin bërë gati për ta lënë Italinë e për t'u kthyer në Shqipëri. Pjesë e grabitjeve të tyre ish-



Vasil Rama

te edhe një vjedhje me vlerë 100 mijë euro e ndodhur pak muaj më parë. Mediat e vendit fqinj pohuan se bëhet fjalë për një familje të tërë shqiptare që merrej me vjedhje banesash, por edhe makinash luksoze, ashtu siç bëri Vasil Rama, shoferi i

"Audi"-t të verdhë.
KUSH ESHTË VASIL RAMA

Vasil Rama, 36-vjeçari shqiptar është personi që udhëtonte me "Audi"-n e verdhë R54 në janar të vitit 2016, duke terrorizuar të gjithë veriun e Italisë për

shkak të shpejtësisë marramendëse deri 270 km në orë me të cilën ngjiste mjetin, gjë që i lejonte të grabiste pa u kapur nga policia. Karabinierët ranë në gjurmët e bandës kur aksidentuan për vdekje një grua. Sipas medive italiane, shqiptari u prangos nga policia e Venecias në kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë. Ai u arrestua falë bashkëpunimit të Ministrisë së Brendshme italiane me policinë greke. Vasil Rama cilësohet nga policia italiane si një person shumë dinak, pasi kishte mundur t'u shpëtonte ndjekjeve të policisë jo vetëm me "Audi"-n e verdhë, por edhe për akuzat të tjera. Ai i ishte arratisur policisë prej 5 vitesh, pasi kishte mbi shpinë aku-



47-vjeçari, pjesë e organizatave kriminale

Kërkohej në Itali për prostitucion, kapet në Tiranë

TIRANË - Një 47-vjeçar është arrestuar nga policia e Tiranës dhe në kryeqytet, me qëllim ekstradimi drejt Italisë. Shtetasi Ilir Balla ishte shpallur në kërkim nga policia italiane, pasi akuzohet për pjesëmarrje në organizatë kriminale dhe shfrytëzim prostitucioni. Më datë 02.11.2017, specialistët për hetimin e trafikut të paligjshëm pranë D.V.P. Tiranë arrestuan përkohësisht me qëllim ekstradimi drejt Italisë shtetasin Ilir Balla, 47 vjeç, banues në Tiranë. Ky shtetas është shpallur në kërkim ndërkombëtar, pasi Gjykata e Catanzaro në Itali, me vendim penal të datës 02.11.2005, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg". Ilir Balla akuzohet për tri veprat penale "Pjesëmarrje në organizatë kriminale", "Heqje e paligjshme e lirisë" dhe "Shfrytëzim prostitucioni", parashikuar nga Nenet 416, 600 të Kodit Penal italian dhe Neni 3, 4 të Ligjit 75/58 mbi prostitucionin dhe heqjen e lirisë. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprimet e mëtejshme, në ngarkim të shtetasit të lartpërmendur. Ndërkohë, policia vijon punën për kapjen e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar.

za për krime kundër pasurisë. Nga hetimet rezultoi se ai shumë herë ka mundur të kalojë kufirin mes Italisë dhe vendeve fqinje me dokumente false. Që kur mjeti u vodh në 26 dhjetor të 2015, u përdor për grabitje nga një bandë e specializuar, e cila

me sa duket kishte zgjedhur 36-vjeçarin Rama për drejtimin e frikshëm. "Audi" kishte arritur t'u shpëtonte të gjitha ndjekjeve të policisë falë shpejtësisë tepër të madhe, ndërsa një herë kishte udhëtuar edhe në sens të kundërt në autostradë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJII I POSAÇEM I APELITIMIT

SHPLLJE E VENDEVE VAKANTE

Kolegji i Posaçëm i Apelitimit (KPA) pranë Gjykatës Kushtetuese, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin e Kuvendit nr.92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organike dhe klasifikimit të pagave të personelit të kolegjit të Posaçëm të Apelitimit", shpall vendet vakante për pozicionet:

1. SPECIALIST FINANCË/BUXHET

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Ekonomi, Dega Financë.
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 5 vite përvojë pune në profesion.
- Të ketë njohuri në programet financiare si: Alpha/Financa 5 etj.

2. SPECIALIST I BURIMEVE NJERËZORE

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në fushën e burimeve njerëzore.

3. SPECIALIST IT

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posacme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor" në Inxhinieri Informatike, Informatike, Teknologji informacioni etj.
- Të ketë të paktën 3 vite eksperience pune në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Të ketë njohuri shumë të mira në administrimin e sistemeve si Active Directory, Outlook Mail Client
- Të ketë njohuri bazë mbi pajisjet e rrjetit dhe infrastrukturën e rrjetit.
- Të ketë njohuri bazë për panelet e administrimit të faqeve web (Wordpress, Drupal, Joomla etj).
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.

4. SPECIALIST PROTOKOLL/ARKIVE

Kandidati duhet të plotësojë këto kritere:

- Të zotërojë diplomë të nivelit "Master Shkencor".
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

- Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për tu pajisur me Certificate Sigurie, sipas Vendimit Këshillit Ministrave nr.188, datë 4.3.2015.
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për tu përshtatur e punuar në grup, nën presion si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në një nga formatet e dhëna më poshtë:

Paraqitjes së Kërkesës nga aplikanti, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë institucionit të KPA-së, në adresën: **Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë, nga e Hëna në të Premte, ora: 09:00-16:00.**

Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës zyrtare pranë institucionit të KPA-së në adresën: **"Bulevardi "Dëshmorët e Kombit, Pallati i Kongreseve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 10 Nëntor 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatit e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPA-ja do të konfirmojë nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentacionin përkatës me anë të postës elektronike nga data 6 Nëntor deri më 10 Nëntor 2017 në adresën: **info@kpa.al.** KPA konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- Kopje të dokumentave (diplomë, letërnjoftimi (ID), librezë pune) original ose të noterizuar. Diplomat që janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal;
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore ne fuqi;
- Vlerësimin e fundit nga Eprori Direkt;
- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe trajnime, kualifikime, arsimin shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Seanca gjyqësore e radhës, më 22 nëntor

Shtyhet gjyqi për ekstradimin e "bosit" të drogës, Alket Hatija



DURRËS - Gjykata e Durrësit dje mori në shqyrtim çështjen në ngarkim të Alket Hatijas, me qëllim ekstradimin drejt Italisë. Në seancën e parë gjyqësore, prokurori i çështjes njohu trupin gjykues me dosjen "Hatija" dhe kërkesën për ekstradimin e tij drejt vendit fqinj. I akuzuari Hatija, i shpallur në kërkim u përfaqësua nga avokati, i cili tha se ai e ka kryer dënimin për veprën penale që e kërkon drejtësia italiane dhe se nuk mund të dënohet dy herë

për të njëjtën veprë. Pasi u njoh me kërkesën e prokurorit dhe palës mbrojtëse, gjyqtari i çështjes vendosi të shtyjë seancën më 22 nëntor, me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit. Alket Hatija u arrestua më 8 korrik të këtij viti me urdhër të Prokurorisë së Durrësit, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga drejtësisë italiane për shkak të një dënimi me 20 vjet burg, të lëshuar nga Gjykata e Apelit në Milano në vitin 2015 për veprën penale të trafikimit ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Më 11

korrik, Prokuroria kërkoi masën e sigurisë "arrestit me burg", me qëllim ekstradimin e Hatijas. Ai u lla i lirë nga gjyqtari Petraq Çuri, duke i dhënë masën "detyrim paraqitje", me argumentin se në dosjen e Hatijas mungonte një kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë. Prokuroria e çështjes në Gjykatën e Apelit, duke paraqitur si provë edhe kërkesën e ministrit të Drejtësisë për aplikimin e masës shtrënguese "arrest me burg" për qëllime ekstradimi.

Pritet ekstradimi i 43-vjeçarit në Kosovë

Kërkohej për vrasje që prej 3 vitesh, arrestohet tropojani

TROPOJË - Një 43-vjeçar i shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje u arrestua dje nga forcat e Drejtorisë së Policisë së Qarkut të Kukësit në bashkëpunim me Forcat e Ndrëhyrjes së Shpejtë (FNSh) të Shkodrës. Bëhet fjalë për shtetasin Shpend Demaj, banues në Tropojë. Mësohet se Demaj u kap, pasi ishte shpallur në kërkim nga autoritetet e Kosovës për veprën penale "Vrasja e rëndë me dashje". Gjatë kontrollit të ushtruar në banesë nga policia, 43-vjeçarit i është gjetur dhe sekuestruar një armë zjarri (pushkë) pa leje. Burime policore bënë me dije se ndalimi i këtij shtetasi u bë me qëllim ekstradimin e tij drejt shtetit të Kosovës, pasi ZQK Interpol Tiranë me shkresë 4604/3KL/, Nr. Prot. BM 233/14, datë 14.05.2014, e ka shpallur në kërkim me kartelë të "Kuqë", pasi autoritetet gjyqësore të Gjykatës së Pejës kanë lëshuar urdhër arresti nr.PP.no.77/12, datë 13.07.2012 ndaj tij për veprën penale "Vrasje e rëndë me dashje", parashikuar nga nenet 147 (9, 11) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës. Materialet në ngarkim të Shpend Demajt do t'i kalojnë Prokurorisë për veprime të mëtejshme.

SHKURT



Biznesmeni xheloz mbyl gruan, kërcënon me jetë kunatat për të mos dëshmuar

SHKODËR - Shteti u ka afruar statusin e dëshmitareve të mbrojtura dy grave në Shkodër, që janë motrat e Suela Sulës, e gjetur e mbytur në tualet nëntë muaj më parë. I akuzuari kryesor është bashkëshorti i të ndjerës, Sadedin Sula, një biznesmen në fushën e mobilierisë, i cili prej nëntë muajsh refuzon të ketë lidhje me krimin. Por dy motrat e viktimës, Flutura Shpori dhe Tatjana Hyseni dëshmuar kundër 47-vjeçarit në një proces me dyer të mbyllura në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Të dyja gratë u sollën me forca policie, pasi siç vlerësojnë autoritetet, atyre u rrezikohet jeta, përderisa pak kohë më parë ndaj Fluturës Shpori është organizuar një atentat për ta vrarë. Flutura Shpori i tha gjykatës se ish-kunati e dhunonte prej kohësh Suelën, por ajo heshti me shpresën se bashkëshorti do të ndryshonte. "Ai ishte xheloz. Nuk e linte kurrë vetëm, madje më e tmerrshme, e akuzonte se 3 fëmijët nuk ishin të tijtë. Një natë dimri e përzuri nga shtëpia dhe unë e gjeta time motër në strehën e portës. Më tregoi se grindja e radhës ishte hapur për njërin nga punëtorët e mobilierisë", dëshmoi Flutura. Dëshmitaret treguan se Sula kishte tentuar ta vraste edhe herë tjetër Suelën, në një rast sipas tyre, ajo ka shfaqur shenja helmimi. Rrëfimi i dëshmitareve është shoqëruar me buzëqeshje nga i pandehuri. Prokurori e pyeti Fluturës Shporin nëse ka frikë. "Po, kam frikë nga Sadedin Sula. Ai është i rrezikshëm. Pas ngjarjes, nuk doja që tre fëmijët e tyre të përfundonin në duart e shtetit, ndaj edhe hapa gjyqin për kujdestarinë. Gjykata e Shkallës së Parë më dha të drejtë, por ditën kur do të shkoja në Apel, më qëlluan me armë. Kam frikë të shkoj në Apel. Nuk dua ta di çfarë vendimi do të japë gjykata. Unë do t'i rris fëmijët e motrës edhe pa vendim gjykate", deklaroi ajo. Për këtë dosje do të rrefejnë me video-konferencë edhe fëmijët e çiftit, të cilët kanë qenë dëshmitarë gjatë dhunës. Prokurori Henrik Ligor i kërkoi ndërkohë gjykatës që të thërrasë dy ekspertë për të vlerësuar disa regjistrime të kryera prej viktimës me telefonin e saj në çaste dhune./TCH

"Personi që aksidentoi me vdekjen tim bir 2 vjeç të vihet para drejtësisë"

Kërcënoi prokurorin pas vdekjes së djalit, procedohet 60-vjeçari

Luftar Buzi: Në letër shkrova "do vras veten e gruan"

FIER

Pesë vjet pas një aksidenti automobilistik ku humbi jetën një fëmijë 2-vjeçar, policia e Fierit ka nisur procedimin penal ndaj babait të viktimës. Bëhet fjalë për shtetasin Luftar Buzi nga fshati Kallm i Vogël i këtij rrethi, i cili akuzohet për veprën penale: "Kanosja e gjyqtarit". Burime zyrtare nga policia lokale dje bënë me dije se në shtator të këtij viti, 60-vjeçari Buzi ka dërguar një letër ankesë tek autoritetet shtetërore, ku nëpërmjet saj ka shprehur ankesën për ngjarjen e ndodhur në vitin 2012, ku si pasojë e një aksidenti ka humbur jetën djali i tij i mitur, Dionis Buzi. Sipas burimeve të mësipërme, Luftar Buzi është ankuar se nuk janë kryer veprimet e duhura hetimore nga ana e Prokurorisë për zbardhjen e ngjarjes. Në këtë letër ai ka kërcënuar me jetë prokurorin e çështjes Ç.S. Ndërkohë, mësohet se dje blutë e fierit kanë shoqëruar prindërit e djalit 2-vjeçar, Luftar dhe Pranvera Buzi.



Pranvera Buzi



Luftar Buzi

AKSIDENTI

Në vitin 2012, një fëmijë 2 vjeç humbi jetën, pasi u aksidentua nga një kamionçinë. Sipas policisë, ngjarja ndodhi në fshatin Kallm të Fierit. Dionis Buzi ishte duke luajtur në rrugë, kur u përplas nga mjeti. Pas aksidentit, i mituri u dërgua me urgjencë në spitalin e Fierit, por nuk mundi t'i shpëtojë vdekjes.

KËRCËNIMI

Pas një aksidenti të ndodhur në vitin 2012, Luftar dhe Pranvera Buzi humbën fëmijën e tyre 2-vjeçar (i mituri u përplas nga një kamionçinë). Pas hapjes dhe rimbylljes dy herë të çështjes për vdekjen e fëmijës, prokurori vendosi ta mbyllë atë, vendim i cili indinjoi prindërit. Luftar dhe Pranvera Buzi, në një letër drejtuar institucioneve kërcënonin prokurorin me vrasje. "Nëse nuk bëhet drejtësi, vrasim prokurorin", shkruhej në letër. Mënjherë pas këtij kërcënimi, policia ka nisur procedimin penal për Luftarin. Pas lirim, i ati i viktimës ka reaguar duke treguar se si qëndron e vërteta e kërcënimeve. 60-vjeçari u shpreh se kërkon vetëm drejtësi dhe se letërën e kanë shkruar

LETRA

"Gjatë gjithë kësaj kohe nuk më është zgjidhur asnjë lloj problemi. I kam dërguar letër Këshillit të Lartë, Gjykatës së Lartë dhe kryeprokurorit. Letër i kam dërguar dhe kryeministrit Rama për padrejtësinë që më është bërë meqë po thoshte 'veting, veting'". Në letër e sipër mund të kem thënë edhe ndonjë tjetër, tha Luftar Buzi.

bashkë me bashkëshorten nën emocion, pasi personi që u aksidentoi djalit me vdekje lëviz për çdo ditë i lirë para banesës së tyre. **REAGIMI** "Nuk e kam kërcënuar me jetë prokurorin. Ai ka përgjegjësinë e vet, pasi e vërteta për aksidentin ku humbi jetën im bir, 2 vjeç, nuk u zbardh". Kështu dek-

laroi Luftar Buzi, i cili akuzohet se bashkë me gruan, Pranverën kanë kërcënuar me jetë prokurorin e çështjes, Ç.S., që gjyko aksidentin fatal të 5 viteve më parë. Luftar Buzi pohoi se shkakton aksidentin u lirua pak orë pas ngjarjes, ndërsa theksoi se çështja u mbyll për të rifilluar sërish. Çifti Buzi kërkon që personi që

PRANVERA BUZI

"Policia erdhi në banesë. Më thanë: 'Mos u tremb, ku e keni armën? Unë u thashë çfarë arme, ne nuk kemi armë'. Kontrolluan shtëpinë time dhe atë të djalit dhe nuk gjetën gjë. Jam në dijeni të letrës, pasi unë e kam shkruar. Nuk kemi pushuar së dërguari letra, por s'kemi gjetur drejtësi. Po nuk më gjetët drejtësi, do gjej drejtësi vetë. Do vras veten, do vras gruan dhe 2-3 të tjerë. Edhe prokurorin, pavarësisht se nuk e njoh", tha Pranvera Buzi.

shkaktoi aksidentin të vihet para drejtësisë. Ndër të tjera, 60-vjeçari Buzi tregoi se i kishte dërguar për këtë rast një letër kryeministrit Edi Rama, ku i shprehte të gjitha shqetësimet e tyre emocionale. Mes të tjerash, ai i kishte shkruar: "Në letër i thashë që do vras gruan dhe veten". Ndërkohë, Pranvera Buzi u shpreh se është

në dijeni të letrës, pasi e ka shkruar vetë, sepse nuk ka gjetur drejtësi. Ajo tha se mbrëmjen e së enjtes, policia shkoi për kontroll në banesën e tyre, ndërsa shtoi se ishte në dijeni të letrës. Nga ana tjetër, avokati i çiftit e cilësoi shkelje nga policia shoqërimin e prindërve, pasi sipas tij, ata nuk përbëjnë rrezik.

Deputetet e Kuvendit mbështesin nismën

Manastirliu: Ndryshime për forcimin e ligjit kundër dhunës në familje

Voltiza Duro

Brenda 9 muajve të parë të këtij viti, 11 persona humbën jetën për shkak të dhunës në familje, mes të cilëve 8 gra. Më tej, sipas statistikave, në këtë periudhë janë regjistruar mbi 3400 denoncime, pasi janë përballur me këtë fenomen, nga të cilat 1940 persona kërkuan urdhër mbrojtjeje. Nisur nga kjo situatë, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu propozoi dhe disa ndryshime për forcimin e ligjit "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Në këtë takim merrnin pjesë edhe zv.kryetarja e Kuvendit, Vasilika Hysi, deputete të Kuvendit të Shqipërisë, ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, si dhe përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare e të shoqërisë civile. "Në përgjigje të rasteve të shtuara të denoncimit të dhunës në familje, në disa raste me pasojë tragjike, rishikimi i ligjit "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", lindi si një domosdoshmëri për të garantuar mbrojtjen e strukturës së familjes nga dhuna", - u shpreh Manastirliu. Ndryshimet ligjore të propozuara nga Ministria e Shëndetësisë parashikojnë afate të qarta procedurale, duke filluar që nga regjistrimi i kërkesës e



Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu gjatë takimit

SHIFRAT

Vetëm në 9 muajt e parë të vitit 2017 janë regjistruar mbi 3400 denoncime për dhunë në familje, nga të cilat 1940 kërkesa u regjistruan për urdhër mbrojtjeje. Në këtë periudhë kohore, 11 persona, 8 prej të cilave gra, humbën jetën.

deri tek ankimet për vendimet gjyqësore, me qëllim që urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të dalin pa asnjë vonesë dhe të sigurojnë viktimën nga rreziku. Një ndryshim tjetër i propozuar lidhet me unifikimin e kohës së nisjes së procedurave në rastet e kërkesës për urdhër mbrojtjeje. Gjykata do të duhet të vendosë për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes jo më vonë se brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kërkesës. Një tjetër ndryshim lidhet me përcaktimin më të qartë të përgjegjësisë

së zyrtarëve në çdo hallkë të zinxhirit të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Të gjitha institucionet përgjegjëse për masat në mbrojtje të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare do të marrin gjaba nëse nuk kryejnë detyrën. "Me ndryshimet që ne propozojmë, viktimat e dhunës në familje do të kenë asistencë ligjore dhe avokat falas nga Dhoma Kombëtare e Avokatëve. Gjithashtu, është parashikuar detyrimi i të gjitha organeve shtetërore për të ofruar falas çdo shërbim ekspertizë të rasteve të dhunës në familje, ndërsa shpenzimet e ekspertëve që thirren nga gjykata do të paguhen nga dhunuesi", tha ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nënkryetarja e Kuvendit, Vasilika Hysi si dhe deputetët Eglanla Gjermani, Klodiana Spahi dhe Nora Malaj e mbështetën nismën, duke kërkuar të dërgohen sa më parë në Kuvend këto ndryshime ligjore.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING COMPANY)

ALBANIA
CITIZEN - CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT
Loan Agreement Project ID No. 8521

Assignment Title: **Advisory Support for the Validation of e-Services**

Ref. No. ALB-8521/CS/CQ/3.10.01

Under the Innovative Good Governance priority, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania" (ISDA), launched in April 2014 and led by the Minister of State of Innovation and Public Administration (MIPA), entails a multilayered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency by using innovative solutions and ICT.

As part of the reform, in October 2014, ADISA, the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania, was created by a Decision of the Council of the Ministers.

To support ISDA Program implementation, the Government of Albania has received key financing from the World Bank under the Citizen Centric Service Delivery (CCSD) Project.

The program aims to improve public service delivery in Albania through a citizen-centric model where central government public services will be provided in an integrated fashion. In terms of the face-to-face channel, the model of the service delivery includes (under ADISA's management) **citizen service centers** established in municipalities, with the largest to be established in Tirana, to offer centralized access to 300+ public services of 15+ public institutions in a single location. Results of key activities linked to the project development objective will be measured through five Disbursement Linked Indicators (DLIs).

DLI #1 (Number of online services with Level 3 automation) measures the number of transactional administrative services provided online with two-way communication, including e-payment and e-filing.

In this framework, ADISA is seeking to hire a qualified Consulting Firm experienced in validating the status of Level 3 (and Level 4) services, and in assessing e-Government programs and ICT implementation in the public sector, with a focus on e-Gov portal applications and online services (further on referred to as 'Consultant'). The Consultant will be responsible for:

- Reviewing and validating the status of online services provided through e-Albania Portal using the UN 2014 framework
- Assessing the performance of several key services through interactions with service providers (government institutions) and beneficiaries (citizens and/or businesses); and
- Reviewing the "e-Service registers" maintained by NAIS and ADISA, and providing a comparative analysis of key findings of this assessment and registry contents to suggest possible improvements.

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant team will consist of one **Team Leader**, who will also work as a key expert (e-Government Specialist and ICT Auditor) a **Key Expert**, and a **Legal Expert** to perform the activities highlighted in this ToR. The consulting firm will have the following qualifications:

1. At least seven (7) years of consulting experience with a focus on e-Government/ICT system design, implementation and assessments, and IT Audit assignments;
2. At least two (2) similar contracts successfully carried out within the last five years with certificates of satisfaction issued by the contracting authority;
3. In-depth knowledge and understanding of ICT and e-Governance development issues;
4. Proven experience in the development of large ICT projects and design of e-Government architecture (including portals and online services);
5. Strong skills and knowledge of international standards and control frameworks (e.g., CoBIT, ISO 27001/27002) and will be essential;
6. Experience in World Bank funded projects related to this assignment will be an advantage;
7. Fluency in English language, spoken and written (for all members of the team); and
8. Key staff with necessary qualifications and experience to successfully carry out all the tasks and deliverables of this assignment. These include but not limited to the following:

The **Team Leader** (e-Gov Specialist and ICT Auditor) shall possess the following qualifications:

1. Masters degree or demonstrated experience in informatics, engineering or related fields;
2. Minimum of ten (10) years professional experience;
3. Minimum of seven (7) years of experience in the design, implementation, and assessment of e-Gov portals for online service delivery (especially transactional and connected services) working with Government institutions;
4. At least five (5) years of experience of ICT Audit in corporate or public sector; and
5. ICT Audit qualification (Certified Information Systems Auditor or equivalent).

The **Key Expert** shall possess the following qualifications:

1. University degree in informatics, engineering, or related fields;
2. Minimum of five (5) years of experience in dealing with e-Gov portals for online service delivery (especially transactional and connected services) and assessment of service provider performance and citizen feedback; and

The **Legal Expert** shall possess the following qualifications:

1. University degree in law.
2. Minimum of five (3) years of experience in the IT related fields and/or e-services

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): www.adisa.gov.al.

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by November 17, 2017, at 12.00 local time

Project Management Unit

Blvd: Zhan d'Ark,

Ish shtëpia e oficerave, Kati V-te

Tirana, Albania

E-mail: roland.larashi@inovacioni.gov.al; and ccsdprojectalbania@gmail.com

Veliaj: Kemi ende shumë për të mësuar nga Holanda

Kryebashkiaku i Tiranës, takim me homologun e Roterdamit, diskutim mbi projektet e përbashkëta

Kryebashkiaku Erion Veliaj priti dhe në një takim kryetarit e Bashkisë së Roterdamit, Ahmed Aboutaleb ku diskutuan mbi realizimin projekteve të përbashkëta. Veliaj vlerësoi bashkëpunimin me ambasaden e Holandës në Tiranë për zbatimin e shumë projekteve e deklaroi se ka ende shumë për të mësuar prej eksperiencës holandeze mbi urbanistikën. "Besoj se kemi ende shumë për të mësuar në çështje të urbanistikës. Me ambasaden e Holandës kemi filluar rrjetin tonë të biçikletave, kemi, gjithashtu, shumë për të mësuar nga



Roterdami dhe besoj që sot është fillimi i një marrëdhënie speciale me Bashkinë e Roterdamit", - u shpreh kreu i Bashkisë së Tiranës. Ndërkaq, kryebashkiaku i Roterdamit, Ahmed Aboutaleb, vlerësoi transformimin që ka pësuar Tirana në një periudhë kaq të shkurtër. Ai theksoi se Tirana po ecën me ritme të shpejta drejt zhvillimit. "Qytetet po luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kombeve, kështu që marrëdhëniet e mira midis qyteteve janë më rëndësi në krijimin e mundësive për qytetarët tanë"-tha Aboutaleb.

INTERVISTE EKSKLUZIVE LOTARIA

Voltiza Duro

Avokati i emigracionit: Kriteret për t'u shpallur fitues, ja ku duhet të keni kujdes

Kieran Both: E pamundur t'i jepet fund Lotarisë Amerikane

"Trump mund të thotë shumë gjëra, por ligji vendos"

Propozimi i presidentit Donald Trump për t'i dhënë fund programit të Lotarisë Amerikane ka lënë në ankth mijëra të interesuar që dëshirojnë të jenë në "tokën e premtuar". Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", avokati amerikan i emigracionit, Kieran Andrew Both sqaron opinionin publik duke theksuar se mblylla e lotarisë është diçka e pamundur: Sipas tij, kreu i Shtëpisë së Bardhë mund të thotë shumë gjëra, por në Shtetet e Bashkuara është ligji ai që vendos. Më tej, avokati tregon se në bazë të statistikave, brenda 5 vitesh mbi 10 mijë shqiptarë kanë fituar të drejtën për të jetuar në Amerikë, falë aplikimeve në këtë program. Ndërkohë, Both nënvizon se arsimi i mesëm apo përvoja e punës janë dy nga kriteret bazë për t'u shpallur fitues e paralizmëron të interesuarit që të kenë kujdes gjatë aplikimit në disa pika të caktuara.

A do t'i jepet fund programit të Lotarisë Amerikane pas propozimit të presidentit Donald Trump?

Presidenti Donald Trump mund të thotë shumë gjëra. Propozimi i presidentit ka shkuar për t'u shqyrtuar nga Kongresi, por në Amerikë është ligji ai që vendos. Është e pamundur që programi i Lotarisë Amerikane të shkojë drejt mblylljes.

Çfarë është programi i Lotarisë Amerikane?

Programi i Vizave të Diversitetit ose DV u themelua nga Kongresi i Shteteve të Bashkuara në 1990 dhe cakton 50.000 viza të përhershme për individë nga vendet me norma të ulëta të emigracionit në Shtetet e Bashkuara. Çdo vit, vendet e përzgjedhura identifikohen nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare dhe Departamenti i Shtetit, bazuar në një analizë të numrit të njerëzve nga çdo shtet i huaj, që kanë marrë statusin e rezidentit të përhershëm në Shtetet e Bashkuara gjatë pesë viteve të fundit. Në 2015-en, që është dhe viti i fundit ku janë të disponueshme statistikave, afro 14.5 milionë njerëz nga e gjithë bota aplikuan për 50.000 vizat e vëna në dispozicion.

Sa është numri i shqiptarëve që kanë fituar lotarinë këto vitet e fundit?

Bazuar në statistikave më të fundit për fituesit shqiptarë të Lotarisë Amerikane rezul-

ton se në vitin 2011 ka pasur 1469 fitues, në 2012 kanë fituar 1508 shqiptarë, në 2013 ka pasur 1520 fitues. Ndërkohë në vitin 2014 numri i fituesve pothuajse është dyfishuar duke arritur shumën 3289, kjo edhe se numri i kërkesave ka qenë i lartë. Ndërsa në vitin 2015 plot 2946 shqiptarë kanë fituar Lotarinë Amerikane. Në 2015-en kemi pasur plot 198, 625 aplikime nga vendi juaj për këtë program. Pra, brenda 5 vitesh, mbi 10 mijë shqiptarë kanë fituar të drejtën për të jetuar në Amerikë nga ky program.

Cilat janë disa prej kriterëve kryesorë që aplikantët duhet të përmbushin për të aplikuar në DV-2019?

Çdo aplikant në programin DV-2019 nga Shqipëria duhet të plotësojë kërkesat për arsim apo përvojë pune të përcaktuara. Kandidati duhet të ketë të paktën një arsim të mesëm ose ekuivalent të tij, i definuar si përfundim i suksesshëm i një kursi 12-vjeçar të arsimit fillor dhe të mesëm. Ose kandidati duhet të plotësojë dy vjet përvojë pune brenda pesë viteve të fundit në një profesion, që kërkon të paktën dy vjet trajnim ose përvojë pune për të kryer. Departamenti i Shtetit do të përdorë bazën e të dhënave 'ONet Online' të Departamentit Amerikan të Punës për të përcaktuar përvojën kualifikuese të punës.

A kualifikohen të gjitha profesionet për t'u përzgjedhur?

Jo të gjitha profesionet



Avokati amerikan i emigracionit, Kieran Andrew Both

KIERAN BOTH

"Presidenti Donald Trump mund të thotë shumë gjëra. Propozimi i presidentit ka shkuar për t'u shqyrtuar nga Kongresi, por në Amerikë është ligji ai që vendos. Është e pamundur që programi i Lotarisë Amerikane të shkojë drejt mblylljes".

kualifikohen për programin e Lotarisë Amerikane. Nëse aplikanti nuk i plotëson kërkesat për arsim ose përvojë pune, do të skualifikohet në kohën e intervistës për vizë dhe nuk do të lëshohen viza për aplikantin ose anëtarët e familjes.

Cilat janë disa nga gabimet që bëjnë aplikuesit gjatë regjistrimit?

Formulari i regjistrimit është i thjeshtë dhe i kuptueshëm. Shumë aplikantë pa arsim të mesëm nuk kualifikohen, për shkak se nuk kanë përvojën e kërkuar të punës. Është për të ardhur keq nëse një person fiton lotari dhe

STATISTIKAT

"Bazuar në statistikave më të fundit për fituesit shqiptarë të Lotarisë Amerikane rezultojn se në vitin 2011 ka pasur 1469 fitues, në 2012 kanë fituar 1508 shqiptarë, në 2013 ka pasur 1520 fitues. Ndërkohë në vitin 2014 ka arritur shumën 3289 fitues. Ndërsa në vitin 2015, plot 2946 shqiptarë kanë fituar Lotarinë Amerikane. Brenda 5 vitesh, mbi 10 mijë shqiptarë kanë fituar të drejtën për të jetuar në Amerikë nga ky program".

Të gjithë fëmijët e pamartuar nën moshën 21 vjeç duhet të jenë të listuar në aplikim gjithashtu.

Si bëhet përzgjedhja e fituesve që u jepet e drejta për të vijuar me intervistën?

Të gjitha aplikimet e marra nga secili rajon janë të numëruara në mënyrë individuale. Në fund të periudhës së hyrjes, një kompjuter do të përzgjedhë rastësisht nga të gjitha aplikimet e marra për çdo rajon gjeografik. Të gjitha regjistrimet e pranuara brenda secilit rajon gjatë periudhës së aplikimit do të kenë shanse të barabarta për t'u zgjedhur. Kur një kandidat është përzgjedhur, ai do të njoftohet nëpërmjet Kontrollit të Statutit të Regjistrimit duke filluar nga 1 maji 2018, në faqen e internetit të E-DV.

Si bëhet kontrolli mbi aplikimet?

Ky proces është jashtëzakonisht i plotë dhe mund të zgjasë shumë muaj. Ekzaminimi i sigurisë përfshin procedurë të shumta, duke përfshirë të dhënat biometrike (shenjat e gishtërinjve dhe fotot) për të konfirmuar identitetin e individit duke përdorur njohjen e fytyrës dhe teknologjitë e tjera; kontrollin e emrave dhe shenjave të gishtave. Madje, bëhet identifikimi për çështjet potenciale kriminale ose të sigurisë kombëtare dhe kontrollin kundër terrorizmit, krimin të organizuar apo bandave. Në rrethanat e caktuara, një "opinion Këshilldhënës i Sigurisë" mund të kërkojë nga selia e Departamentit të Shtetit përpara se të lëshohet viza. Përveç kësaj, të gjithë fituesit e Lotarisë së DV duhet të kalojnë intervistën dhe përsëri kontrollohen për pranueshmëri përmes pyetjeve të kujdesshme. Nëse ka ndonjë shkelje, viza e kandidatit mund të mohohet.

Cilat janë tarifat që duhet të paguajnë aplikantët?

Nuk ka pagesë për të aplikuar në këtë program. Nëse kandidati aplikon për një vizë të diversitetit, të gjitha pagesat e kërkuara për vizë duhet të paguhen në kohën e aplikimit direkt në arkëtarin konsullor të SHBA. Ky i fundit do të lëshojë një faturë qeveritare të SHBA-ve për pagesat. Aplikantët nuk duhet të dërgojnë para për pagesat e DV-së përmes postës, "Western Union" ose ndonjë shërbimi tjetër të shpërndarjes nëse ata aplikojnë për një vizë emigrimi në një ambasadë ose konsullatë të SHBA-ve.

Çfarë ndodh me fituesit pasi ata fitojnë një jetë të re në Amerikë?

Fituesit e Lotarisë do të marrin vendbanimin e përhershëm të ligjshëm të quajtur "Green Card" në Shtetet e Bashkuara. Ata kanë të drejtë për të gjitha përfitimet dhe privilegjet e atij statusi. Karta e gjelbër lejon personin të hyjë në Shtetet e Bashkuara pas udhëtimit jashtë vendit. Sigurisht, ata janë përgjegjës për pagimin e taksave dhe duhet të njoftojnë USCIS nëse ata ndryshojnë adresën e tyre.

Nëse individit jeton në Shtetet e Bashkuara, si mund të marrë autorizim për punë?

Një kartë e gjelbër (Formulari I-551, letër e përhershme rezidente) është dëshmi e autorizimit për punësim. Shumicës së individëve u caktohet një numër i sigurimit social kur merr një vizë emigrimi. Punëdhënësit e mundshëm mund të përdorin informacionin në ato karta për të verifikuar pranueshmërinë e punësimit.

Si procedohet për të marrë shtetësinë amerikane?

Një person që disponon për 5 vjet një "Green Card" apo kartë jeshile mund të aplikojë për shtetësinë. Por ekzistojnë edhe kërkesa specifike për raste të tjera.

Si procedohet për të marrë shtetësinë amerikane?

Një person që disponon për 5 vjet një "Green Card" apo kartë jeshile mund të aplikojë për shtetësinë. Por ekzistojnë edhe kërkesa specifike për raste të tjera.

Një person që disponon për 5 vjet një "Green Card" apo kartë jeshile mund të aplikojë për shtetësinë. Por ekzistojnë edhe kërkesa specifike për raste të tjera.

Një person që disponon për 5 vjet një "Green Card" apo kartë jeshile mund të aplikojë për shtetësinë. Por ekzistojnë edhe kërkesa specifike për raste të tjera.

Përmbasuri gjyqësore Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :
a) Tokë are e regjistruar në regjistrimin hipotekore me nr pasurisë 1111/22, volumni 5, Fage 27, në zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 5990 m², e ndodhur në adresën: Gur i Zi - Shkodër
b) Tokë are e regjistruar në regjistrimin hipotekore me nr pasurisë 114/56, volumni 7, Fage 48, në zonen kadastrale nr 1898, me sipërfaqe totale 3492 m², e ndodhur në adresën Gur i Zi - Shkodër
1. Çmimi me të cilin do të fitojë shitja në ankand është në masën sic caktojmë me postho
a) për pasurinë "Toka Are" me sipërfaqe 1.920.000 leke
b) Për pasurinë "Toka Are" me sipërfaqe 3492 m², është në vlerën 1.400.000 leke
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 14.11.2017 ora 16.16 në Zyren e përmbasurisë gjyqësore Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Portëllë Gjyqësore Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tiranë Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

Përmbasuri gjyqësore Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :
"Apartament" me sipërfaqe 127 m², e regjistruar në regjistrimin hipotekore me nr 82 date 02.06.2011 me volumni 5 fage 108 me nr pasurisë 16/130-1-8, në Zonen Kadastrale 8597 me adresë, lagja "Pazarar", Shkodër
2. Çmimi me të cilin do të fitojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpërkuruar, është në vlerën 3.124.800 (tremiliona e njëqinda e njëzetastat mijë e tetëqinda) leke
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 15.11.2017 ora 16.16 në Zyren e përmbasurisë gjyqësore Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Portëllë Gjyqësore Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dhe Shkodër me nr llogarie 41064051, ose në Tiranë Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

Përmbasuri gjyqësore Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurine :
a) Tokë are e regjistruar në regjistrimin hipotekore me nr pasurisë 58/21, volumni 10, Fage 248, në zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 3220 m², e ndodhur në adresën Barbullush Shkodër
b) Tokë are e regjistruar në regjistrimin hipotekore me nr pasurisë 52/3/21, volumni 9, Fage 3, në zonen kadastrale nr 1100, me sipërfaqe totale 2360 m², e ndodhur në adresën Barbullush Shkodër
1. Çmimi me të cilin do të fitojë shitja në ankand është në masën sic caktojmë me postho
a) për pasurinë "Toka Are" me sipërfaqe 3220 m², është në vlerën 697.680 leke
b) Për pasurinë "Toka Are" me sipërfaqe 2360 m², është në vlerën 509.760 leke
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 08.11.2017 ora 16.16 në Zyren e përmbasurisë gjyqësore Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko, Portëllë Gjyqësore Shkodër. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Tiranë Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100.

FESTIVALI NDERKOMBETAR I FLIMIT

254 filma nga e gjithë bota në kohë krize për filmat dhe ki nemanë e pavarur, janë përgjigja që Tirana International Film Festival ka për publikun në përvjetorin e 15-të që zhvillohet nga 3 deri me 11 nëntor. Anëtar i jurisë, regjisori dhe producenti i njohur kanadez Denis Cote dhe regjisori shqiptar Fatmir Koçi pohojnë se kriza e audiencave nuk është vetëm një problem shqiptar por kinemaja independente duhet të kërkojë shikuesin kritik përtej kllisheve të filmit hollivudian.

Është çelur mbrëmë edicioni i 15-të i Festivalit Ndërkombëtar të Filmit, TIFF 2017 në ambientet e kinema Milenium me premierën europiane të filmit "Elvis Walks Home" nga Fatmir Koçi. Ky edicion do të mbahet në sallat e kinemave Imperial të kinema Agimi, Teatri i Kukullave dhe TULLA Culture Center nga data 3-11 nëntor. Motoja apo slogani i këtij edicioni të 15-të është: Picture your Life - Create the Future. TIFF është event i më të rëndësishëm kinematografik që zhvillohet në Shqipëri jo vetëm për nga vjetërsia dhe përvoja, por edhe për numrin e madh të aplikimeve dhe aftësinë selektive të filmave, programit të pasur dhe zbulimeve interesante. TIFF vazhdon të mbetet një festivali i pavarur, që ka për qëllim të zbulojë e promovojë atë kinematografi europiane e botërore, që për fat të keq mbetet jashtë rrjetit komercial të distribucionit. TIFF mbetet e vetmja mundësi për t'ofruar audiencës këtë prodhimtari që nuk shfaqet në kinema e as në TV e që nuk ka mundësi të promovohet gjërisht, siç e meritojnë kualitetet e konstatuara nga viti në vit. Edicioni i 15-të i Tirana International Film Festival shënoi një numër rekord prej 1,511 aplikimesh duke pasur në konsideratë që këtë vit për herë të dytë TIFF aplikoi Entry Fee për të gjithë pjesëmarrësit, përveç filmave në shqip. Ky numër i lartë i aplikimeve tregon edhe njëherë reputacionin e lartë që TIFF ka arritur ndër vite me një seleksion të kurrur imtësisht dhe një program të pasur artistik. Prurjet e këtij edicioni nga 113 vende të botës vërtetojnë më së miri honoren që TIFF ka përhapur në botë, si një festivali i pavarur dhe me kritere të larta profesionale. Këtë edicion rritet në rreth 254 numrin e filmave që do të shfaqen për publikun tonë dhe të huaj. Pothuajse të gjithë filmat që do të shfaqen në TIFF 2017 janë premiera kombëtare e disa prej tyre edhe premiera rajonale, europiane e botërore.

PROGRAMI I KONKURIMIT

Përfshin filma të gjatë, dokumentarë, filma të shkurtër, filma të animuar, filma shqiptarë, video art dhe film studentësh. Këtë vit ka një ndryshim në strukturën e programit në konkurrim, duke i dhënë një hapësirë të gjerë filmit dokumentar me metrazh të gjatë, të mesëm e të shkurtër. Përveç programit kualitativ në konkurrim me filma të vlerësuar gjërisht në festivalet më të rëndësishme europiane të kategorisë A me 167 filma në konkurrim, do vazhdojmë traditën me dy programet kryesore speciale PANORAMA dhe FOCUS me 87 filma. FOCUS është i përbërë nga disa programe ku më i spikatur



Nis TIFF me moton "Pikturoni jetën tuaj"

Festivali homazh për Viktor Gjickën mbahet në datat 3 deri më 11 nëntor



është homazhi kushtuar regjisorit të madh shqiptar Viktor Gjicka, me rastin e 80-vjetorit të lindjes. Në bashkëpunim të ngushtë me AQSHF organizohen shfaqjet e 4 filmave të tij më të spikatur të subtitruar në gjuhën angleze për spektatorët e huaj mysafirë të TIFF.

Programi i ri në FOCUS do të jetë MADE In ALBANIA ku do të shfaqen për herë të parë prodhime kinematografike të realizuara në Shqipëri apo në gjuhën shqipe. Ky program, sipas organizatorëve, reflekton rritjen e ndjeshme të prodhimit kinematografik në Shqipëri e Kosovë, sidomos të filmit i pavarur. Këtë edicion në fokus është filmi izraelit i dy viteve të fundit, një program special i mundësuar nga distributori partner Go2Films me 4 filma të suksesshëm. Festivali partner, Dokufest sjell programin FUTURE IS HERE me prodhimet e edicionit të fundit të tyre të realizuar nga studentët nga Shqipëria, Kosova dhe Ballkani. Në FOCUS mbetet po ashtu edhe programi special më tradicional i TIFF: Reflecting Albania. PANORAMA është seksioni me filma që i dedikohen programeve tematike për fëmijët, adoleshentët, gratë, problemet midis

brezave, emigracionin dhe plagët e krizës botërore financiare dhe të identitetit, integritetit të personave

me aftësi të kufizuara, LGBT, panoramës ballkanike të filmave të shkurtër, etj. me këto seksione: BALKANorama (competition), KIDS, DIVERGENT MINDS, GENERATIONS, New World; PARADE.

Veçanërisht filmi për fëmijë ka qenë një synim i veçantë gjatë programit të edicionit të 15-të duke i kushtuar një hapësirë të veçantë me filma të metrazhit të gjatë, fikcion dhe animacion si një investim afatgjatë për rritjen e audiencës shqiptare në kinema dhe stimulimin e fëmijëve e të rinjve me frekuentimin e sallave të kinemave si vende edukimi, kulturimi dhe rekreacioni. Për këtë arsye kemi bashkëpunuar ngushtë me Qendër Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe filmat e këtij programi do t'i shfaqin të Teatri i Kukullave, si një vend familjar e tradicional për argëtimin e fëmijëve.

SPECIAL SCREENINGS do të ketë premierën rajonale të filmit dokumentar të vlerësuar në Locarno Film Festival, "A Skin So Soft" nga regjisori i mirënjohur kanadez, Denis Côté, i cili do ta prezantojë personalisht premierën në Tiranë para publikut të interesuar. Në vijim të projektit të suksesshëm që startuam vitin e kaluar FESTIVAL TO DATE, Festivali Simultan si një skemë inovative të shpërndarjes së filmit europian, në bashkëpunim me CutAway, partnerin tonë maqedonas, dhe të mbështetur nga programi MEDIA i Creative Europe do të sjellim dy premiera të suksesshme të metrazhit të gjatë: Paolo dhe filmi për fëmijë Raffi, respektivisht të premtën, datë 10 nëntor ora 17:00 dhe të shtunën, datë 11 ora 11:00, të kinema Agimi dhe Teatri i Kukullave.

Sipas projektit të miratuar këto filma do të shfaqen në mënyrë simultane në të njëjtën ditë dhe orë në Tiranë dhe në Shkup gjatë Festivalit Europian të Filmit Cinedays si dhe në platformën VOD Cinesquare.net.


Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit do të mundësojë për publikun shfaqjen e programit FOCUS dedikuar regjisorit të madh shqiptar Viktor Gjicka të 4 filmave të tij në 35mm dhe të subtitruar në gjuhën angleze.

JURIA E ÇMIMET

Gjashtë juri ndërkombëtare të formuara nga regjisorë, skenaristë, producentë, distributorë, kritikë filmi, gazetarë, etj. si dhe juria tradicionale e Medias do të vlerësojnë 167 filma në konkurrim për çmimet në kategoritë e mëposhtme: BEST FEATURE FILM, Best Director, Best Screenplay, Best Cinematography, Best Editing "Luc Barnier", Best European Feature Film, Best DOCUMENTARY, Best Documentary Full-length, Best Documentary Mid-length, Best Documentary Short, Best SHORT FICTION, Best SHORT ANIMATION, Best STUDENT Film, Best VIDEO ART, Best Film In ALBANIAN, Best European Short Film, Best BALKANFilm, Best DEBUTFilm "Ron Holloway" Award dhe MEDIAAward AUDIENCEChoice Award.

SHPËTOHET ARKIVI I KRYQIT TË KUQ

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave dhe Kryqi i Kuq Shqiptar nënshkruan dje një marrëveshje për dixhitalizimin e plotë të të gjithë dokumentacionit të të gjithë fondit arkivor të Kryqit të Kuq që nis prej periudhës përpara çlirimit deri në fund të komunizmit. Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, Arditi Bido falënderoi Sekretarin e Përgjithshëm të Kryqit të Kuq, i cili u përgjigj menjëherë ftesës për të realizuar këtë projekt në interesin e të përbashkët të dy institucioneve. "Dokumentacioni që do të dixhitalizohet me njëjtë e vendosura në dispozicion nga Kryqi i Kuq Shqiptar është i rëndësishëm për t'u ruajtur në bazë të të gjitha normave ndërkombëtare të arkivistikës. Projekti vjen në kuadër të projekteve të ngjashme që Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave ka kryer me institucione të tjera në



vend në mënyrë që të arrijmë dixhitalizimin masiv të fondeve arkivore të institucioneve që kanë mundësi ta kryejnë këtë detyrë në një kopje dixhitale në Drejtorinë e Arkivave dhe një kopje dixhitale ta kenë ata si fondkrijues që është një prej dy objektivave tona në kuadër të dixhitalizimit, krahas dixhitalizimit on-demand që do të nis vitin e ardhshëm, pra dixhitalizimi masiv i dokumentacionit në kuadër të projekteve, në të cilat në pamundësitë tona buxhetore janë

në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera që përbën një hap të rëndësishëm në mënyrën se si konceptohet ky proces kaq i rëndësishëm për ruajtjen e dokumentacionit arkivor", tha Bido. "Jemi të lumtur për këtë bashkëpunim dhe mbi të gjitha për këtë mundësi që Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave na ofroi. Për Kryqin e Kuq Shqiptar historia është një aspekt i rëndësishëm për shoqatën dhe shoqërinë shqiptare, sepse është shoqata më e vjetër në vend që është krijuar në vitin 1921 dhe kjo lloj mundësi që Drejtorja e Përgjithshme na ofron na ndihmon dhe nga pikëpamja historike dhe nga pikëpamja e kërkesave që kemi në lidhje me shumë kërkime", - tha Katuçi.



BLUE TOOTH

Thashë theme
MADE IN ALBANIA

Nr. 583

SUPLEMENT I PERJAVSHEM

GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtune 4 Nëntor 2017

FITUESIT NDER VITE

VENDIMI I PAPRITUR



Mbyllet "Big Brother Albania"



KRYEMINISTRI I KOSOVES ME SHOFERE PERSONALE

KRISJA E ÇIFTIT KRENAR COCAJ XHELOZ PER LUANA VJOLLCEN

Fotot provokuese, daljet ekstravagante, arsyeja e sherrit mes dyshes. Ja çfarë ka ndodhur mes çiftit



Kush janë femrat VIP që pas dashurisë u bënë të pasura



E la i dashuri për Samantën, ja mesazhi që i dërgon ajo këngëtares

Një mesazh i çuditshëm ka mbërritur në adresë të këngëtares shqiptare, Samanta Karavello. Bukuroshja e ka cilësuar si mesazhin e ditës, pasi ndoshta nuk e ka besuar, por, nëse ka ndodhur me të vërtetë, do të ishte një histori shumë e trishtë. Një vajzë është braktisur nga i dashur, pasi ai dashuronte shumë këngëtares shqiptare. Ata sot nuk janë më bashkë, por pavarësisht kësaj, duke ditur dashurinë e madhe të ish-partnerit për Samantën, ajo i ka dërguar një mesazh këngëtares ku shpreson që ata të takohen një ditë. "I dashuri im të dashuron. Por, tanimë ne jemi ndarë. Uroj që ai të të takojë", -i ka shkruar vajza, Samantës. Këngëtarja ka postuar foton në profilin e saj në "Instagram", ku thjesht shkruan: "Mesazhi i ditës", shoqëruar me një fytyrë duke qeshur me lot. Nuk e dimë se cila ka qenë përgjigja e këngëtares, por nisur nga reagimi i saj, besojmë se edhe ajo është treguar paksa skeptike për vërtetësinë e këtij mesazhi.



Klaudia Pepa trondit Milanon kështu nuk e kishim parë...

Balerina e njohur Klaudia Pepa është vënë sërish në qendër të vëmendjes mediatike me foton e fundit që ka publikuar në rrjetet sociale. Në këtë foto Pepa ka treguar se aktualisht ndodhet në Milano, por ajo që bie më tepër në sy është pjesa e dekoltesë së balerinës, të cilën nuk ka nguruar ta ekspozojë. Gjithashtu, ajo duket mjaft elegante e veshur me të zeza. Postimet në rrjetet sociale kanë qenë mjaft të shpeshta e tejet provokuese. Kujtojmë se vetëm pak kohë më parë Klaudia ka qenë në qendër të vëmendjes për shkak të divorcit me koreografin e njohur Albi Nako, divorc i cili bëri mjaft bujë.

Benardi i komenton në foto, Xheni e degjeneron me përgjigjen e saj

Ka marr fund çdo gjë", shkroi Xheni pak ditë më parë duke konfirmuar njëherë e mirë se ajo dhe Benardi nuk janë më bashkë. Por mesa duket dyshja nuk janë ndarë aspak mirë, ndryshe nga sa u shfaqën në "Dance with me". Kjo kuptohet nga komentet dhe replikat me njëri-tjetrin në një foto të Xhenit ku shfaqen dy bluzat të stampuara me fotot e tyre, dhuratë nga fansat.

"Tlitem fshije dhe këtë", -i shkruan Benardi Xhenit ndërsa ajo ia kthen me injorim: "A mundesh të mos me shkruash më? Është profili im! E s'e kam mbajtur për ty, po sepse kam respekt për njerëzit që na kanë mbështetur. Shiko punën tënde. Ciao". Kaq është dashur që mes fansave të tyre të plasë shërri, ndërsa Benardi nuk i ka kthyer më përgjigje Xhenit. Dy ish-banorët i kanë fshirë të gjitha fotot që kishin së bashku nga "Instagrami", ndërsa kujtojmë që Xheni është larguar nga Shqipëria.



Liked by big_brotheralbania_news and 5,155 others
jennymhillaj_95 Faleminderit per mbështetjen që na jepni çdo ditë, skam fjalë për atë që bëni për ne...ju jeni thjesht e mrekullueshme. Ju du shumë shpirtat e mi! ❤️
#loveyou

View all 86 comments

benard_marashi1 Tlitem fshije dhe ket!

jennymhillaj_95 @benard_marashi1 a mundesh mos me shkrujt ma?? Asht profili i im! E se kam majt per ty, Po pse kam rrespekt per njerzt se na ken mbeshtet! Shif punen tane. Ciao.

MAY 30 • SEE TRANSLATION






FOTOT PROVOKUESE, DALJET EKSTRAVAGANTE, ARSYEJA E SHERRIT MES DYSHES

Krenar Cocaj xheloz, kriset marrëdhënia me Luana Vjollcën

Ja çfarë ka ndodhur mes çiftit

Pamela Aliaj

A ta përfliten se janë një ndër çiftet më romantikë të show bizit. Gjithnjë e rrethuar nga lulet e dhuratat e jo vetëm, Luana dhe partneri i saj, Krenari, edhe pse nuk kanë dashur të hedhin foto së bashku në rrjetet përkatëse sociale, duken shumë të dashuruar. Por kjo para se të merrnim vesh se gjërat nuk shkojnë edhe aq fushë me lule për çiftin. Burime për "Blue-tooth" të "Gazeta Shqiptare" kanë thënë se kanë filluar krisjet e para për çiftin e ri shqiptaro-kosovar. Mesa duket Krenari paska disa nota të ndjeshme xhelozie ndaj asaj që para disa kohësh e quajti "gruaja ime". Mos vallë për shkak të veshjes së ekzagjeruar të bukuroshes Luana, e cila spikat me format e saj bombastike në rrjetet sociale. Para pak kohësh ka nisur edhe emisioni i ri, i cili është nën drejtimin e bukuroshes Luana të quajtur "Shiko kush luan". Në postimet e saj të fundit, si edhe në të mëparshmet, moderatorja seksi shfaqet tepër sensuale dhe provokuese me dekolte që bie shumë në sy. Një gjë e tillë i ka "ndezur" fansat e saj duke i bërë komente nga më të ndryshmet. Mbase kjo e ka shtuar akoma edhe më tepër xhelozinë e biznesmenit nga Kosova. Edhe pse, të



themi të drejtën, nuk është hera e parë që ai shfaq nota xhelozie ndaj bukuroshes Vjollca, duke bërë që kjo e fundit të stepet në disa postime të saj. Por nuk kemi folur më parë për një krisje të tillë. Duke qenë se edhe si tradicionalë që janë kosovarët parapëlqejnë që gruan ta kenë për vete dhe më serioze në pamjen e saj. Një gjë e tillë u vu re edhe me motrën e Luanës, Marinën, e cila u bë më e rezervuar edhe më serioze në postimet e saj. Gjithashtu, mund të themi se çifti u pa të ishte pjesë e muajit të mjaltit të çiftit Marina-Geotiar, ku Luana nuk harroi të postonte foto të shumta provokuese dhe statuse nga parajsja e egër ku bukuroshja seksi dukej shumë sensuale e veshur me bikini. Kjo nuk është pasuar me ndonjë reagim negativ të partnerit të saj. Përkundrazi, kujtojmë që në një foto ku ajo kishte dalë me të brendshme të "Calvin Clain", Krenari nuk kishte harruar të lë një koment aspak "kompromentues", duke shkruar "Smoking hot" (shumë tërheqëse). Ende nuk dihen arsyet e vërteta të kësaj krisjeje mes çiftit, por do të shohim nëse do të ketë ndonjë ndryshim në sjelljen apo edhe veshjen e Luanës në puntatën tjetër të "Shiko kush luan" për të kuptuar edhe më qartë arsyet e kësaj sjelljeje të Krenarit.

Ja kush janë fituesit ndër vite të "show"-t televiziv

Vendimi i papritur, mbyllet "Big Brother Albania"

Cilat janë arsyet që çuan në pezullimin e shfaqjes së famshme

Pamela Aliaj

S i çdo vit në ekranet e shqiptarëve, transmetohet një ndër show-t më të mëdhenj televiziv i ndjekur në Shqipëri edhe më gjerë, "Big Brother Albania". Ai pati një sukses shumë të madh për vite me radhë, dhe jo vetëm për shkak të audiencës së gjerë që e ndiqte çdo vit transmetimi për 3 muaj me radhë, por, gjithashtu, edhe për personazhet e spikatur e të veçantë që shfaqëpënia më e famshme në Shqipëri, kishte. Por mesa duket, këtë vit nuk kanë nisur audicionet për "Big Brother Albania 10". Kjo është vënë re edhe nga mungesa e spotit publicitar që niste që në shtator për përgatitjen dhe paraqitjen e pretendentëve në audicionet e fshehta, por, gjithashtu, është konfirmuar edhe nga burime të brendshme për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", duke thënë se produktioni do ta bëjë "pushim" këtë vit duke pritur se vitin tjetër do të ketë të reja akoma më interesante lidhur me shtëpinë më të famshme në Shqipëri. Mbase mund të marrin sërish formatin e huaj duke futur brenda saj jo njerëz të thjeshtë për t'i bërë të famshëm, por mbase VIP-a që tashmë janë të njohur dhe shumë të dashur për publikun. Megjithatë ende nuk është thënë fjala e fundit për surprizat, që na pret sezoni i ri, por një gjë është e sigurt, që produktioni ka një vit të plotë kohë për ta bërë këtë show akoma edhe më surprizues dhe të dashur për shikuesit. Ndërkohë kujtojmë ndër vite fituesit e 9 sezoneve të "Big Brother Albania". Ku janë ata tani? Me çfarë merren? A iu shërbeu sadopak fama që morën apo u mjaftuan me çmimin e madh?

ARBRI

"Big Brother 1", duke qenë se ishte dhe i pari në transmetim nga TCH kishte një



audiencë shumë të madhe. Fituesi i parë doli një djalë i mirë dhe shumë i shkolluar si Arbrit. Loja e Arbrit ishte shumë "low profile", duke transmetuar kulturë dhe tolerancë tek të gjithë konkurrentët e tjerë. Qetësia që e karak-

terizoi gjatë gjithë lojës i siguroi Arbrit një vend në finalen e madhe dhe më në fund fitoren. Arbrit ishte një fitues, i cili përdori shumë pak strategji për të fituar pasi ishte formati i parë i reality show në Shqipëri.

QETSORI


Ai ka qenë edicioni më i ndjekur, pa dyshim, ndër 9 edicionet e transmetuara deri tani, duke shtuar, gjithashtu, se ishte edhe më aktiv i "Big Brotherit". Edicioni i dytë ka qenë një edicion me plot in-

triga, dashuri, miqësi, seks dhe përplasje. Përzgjedhja e karaktereve në këtë edicion ishte perfekte duke ndërthurrur shumë lloje temperamentesh dhe karakteresh në një format të vetëm. Fituesi i këtij edicioni ishte Qetsori, i

Kryeministri i Kosovës me shofere personale



Kryeministri Ramush Hajradinaj dhe bashkëshortja e tij Anita i preferojnë shumë udhëtimet. Duket se lideri i Kosovës ka një shofere personale, që e do fort dhe që e shoqëron kudo. Bëhet fjalë për Anitën, e cila në foton e fundit, të publikuar në rrjetet sociale, tregon se është shoferja e tij personale. Bashkëshortët shihen ngado në shoqëri të njëri-tjetrit. Anita me duart në timon dhe kryeministri duke përshëndetur, të dy të buzëqeshur duken mjaft pozitivë.



lidhje brenda shtëpisë. Të gjitha këto e vendosën Jetmirin në qendër të vëmendjes duke fituar kështu edhe simpatinë e të gjithëve.

ERMELA

Ajo ishte fituesja e parë femër pas 3 edicioneve të "Big Brother Albania". Ermela ishte një nga konkurrentet më inteligjente dhe që luajti më së miri me gjithë karakteret e pjesëtarëve në lojë dhe u kurorëzua si mbretëresha e edicionit numër 6. Ajo mbajti një qëndrim perfekt ndaj të gjithë pjesëmarrësve të tjerë duke u përpjekur gjithmonë për të provokuar anën më të keqe të karakterit të tyre.

ARBRI

Ky ishte një ndër të vetmit edicione ku u diskutua shumë për fituesin, pasi të dy konkurrentet final Arbri dhe Liam luftuan ashpër me njëri-tjetrin për çmimin final të 100 milionë lekëve. Fituesi doli Arbri nga Kosova, një nga të vetmit fitues që janë futur në mes të lojës në "Big Brother" dhe kanë fituar çmimin e madh. Loja e tij gazmore dhe humori i tij e bëri shumë shpejt që të dali në pah karakteri i tij lozo-njar. Arbri ishte i pari fitues nga Kosova në BB Albania.

ANAIDI

Një edicion, i cili nxori një fitues të padiskutueshëm si Anaidi. Loja e tij u bazua në një inteligjencë të mprehtë që u dallua qartë në marrëdhëniet e tij me gjithë lojtarët e tjerë të "Big Brother". Anaidi ishte fantastik në zbulimin e gjithë sekrereve të konkurrentëve të tjerë, gjë që ishte një nga qëllimet kryesore të edicionit numër 6. Ana e tij e ndjeshme ku ishte prej vitesh mik me një djalë me aftësi të kufizuara, e vlerësoi akoma më tepër si lojtar duke i dhënë pikë më shumë për të arritur më pas fitoren e edicionit të BB6.

NEVILA

Ky është "Big Brother" i dytë ku u diskutua mbi fituesin. Ajo ishte fituesja e dytë femër, vajza gjirokastrite, e

cila ishte rritur pa prindër. Nevila, një vajze e vuajtur nga periferitë tregoi një karakter shumë të qetë e miqësor me të gjithë. Shumë personazheve një sjellje e tillë duket se u pëlqeu, ndërsa shumë të tjerë e kanë urreyer si personazh. Por, gjithsesi, ajo arriti të fitonte çmimin e madh prej 100 milionë lekësh. Mbasa më shumë se aftësitë e saj, votimet e audiencës ishin për shkak të gjendjes së saj të mjerueshme dhe jetës nga e cila ajo vinte, duke përfituar kështu çmimin e madh.

VESELI

Rrugëtim 100 ditësh i Veselit ishte i mbushur jo vetëm me romanca, por, gjithashtu, u ballafaqua edhe me sfida të shumta. Pasi i rrëzoi nga loja katër konkurrentë, ishte Alba ajo që mbeti me të në fund si finaliste e vetme. Më në fund votat e publikut e dhanë fituesin në show-t që shumë herë u kontestua. Kësaj radhe megjithatë nuk kishte dyshime, sepse Veseli kishte përkrahjen më të madhe dhe ishte favoriti për ta fituar garën. Ai arriti të fitojë çmimin prej 100 milionë lekësh, i cili ndahet pasi të dalë nga shtëpia. Veseli, një djalosh nga Prizreni arriti që gjatë gjithë periudhës sa ishte në "Big Brother Albania 8" të shfaqë karakter dhe të reflektojë mashkullin tipik kosovar.

DANIEL DHE FOTINI

Ndryshe nga gjithë vitet e tjera, "Big Brother Albania 9" vendosi të sillte fitues një çift dhe jo një person. Që në fillim përzgjedhjet e formatit ishin bërë me çifte ku spikasin edhe fituesit Daniel dhe Fotini. Loja e tyre ishte akoma edhe më interesante duke qenë se ata u bënë çift brenda shtëpisë së famshme, dhe jo vetëm aq, por, gjithashtu, ata përfunduan duke u martuar, duke bërë kështu që për herë të parë pas 8 edicioneve, të realizohej një show i tillë përpara syve të mijëra ndjekësve brenda dhe jashtë vendit.



cili ka qenë që prej ditës së parë deri në fund i nominuar. Loja e tij e "pisët" dhe agresive e solli atë në qendër të vëmendjes të reality show-t. Një ndër armët e tij më të forta ishte dhe roli i leadership-it (drejtuesit) që e karakterizon-

te në shtëpi, ku ai ishte kuzhinieri kryesor dhe iniciatori i çdo debati.

JETMIRI

Edicioni i tretë ishte një edicion, i cili u karakterizua nga një spektakël i jashtëzakonshëm dhe karaktere të

shumtë. "Big Brother 3" ishte një luftë e vërtetë. Fituesi doli Jetmiri, konkurrenti nga Vlora, i cili ishte një kopje identike e Qetsorit. Ai ishte mjaft agresiv dhe prepotent ndaj gjithë konkurrentëve të tjerë dhe arriti të krijojë edhe një

Nga Andrra Destani te Zaimina, ja bizneset e bukurosheve

Kush janë femrat VIP që pas dashurisë u bënë të pasura

Vajzat e show-bizzit, që pas partnerëve të pasur drejtojnë biznese të mëdha

Pamela Aliaj

Ditët e sotme është një ndër trendet e kohës të qenit e pavarur dhe të pa surit një biznes privat. Dhe, nëse kësaj i shtojmë dhe faktin se bëhet fjalë për figura të njohura të show-bizzit, e pse jo! Të shumta janë femrat VIP, të cilat pas karrierës së tyre në botën e spektaklit, kanë zgjedhur të krijojnë dhe shfrytëzojnë me figurën e tyre, një biznes privat. Të shumta janë bukuroshet e ekranit, të cilat i janë drejtuar botës së biznesit duke zgjedhur rrugë të ndryshme ku të "shkëlqejnë" duke vënë në provë aftësitë e tyre si "businesswoman". Dhe ia kanë dalë, të shumta janë ato, të cilat kanë arritur të krijojnë një sukses edhe në këtë fushë. Por, duke ditur se fillimi është i vështirë, fama e emri që ato kanë bërë, përveç reklamave, ka qenë faktori numër një që u ka sjellë atyre një sukses të tillë. Gjithashtu nuk duhet të harrojmë se të nisurit e një biznesi kërkon kapital, gjë të cilën jo të gjitha e kishin, kështu që mund të shtojmë se të pasurit në krah të një partneri sjell jo vetëm mbështetje shpirtërore dhe fat në dashuri, por, gjithashtu, edhe në biznes. Ndër to mund të përmendim disa prej VIP-ave, të cilët janë sot businesswoman të suksesshme apo edhe në hapat e para të tyre:

ALKETA VEJSIU

Bukuroshja moderatorë, ikona e famshme e televizionit Klan nuk është vetëm një figurë e dashur dhe drejtuese e shumë show-ve të njohur, por, gjithashtu, ajo ka edhe një biznes të saj. Edhe pse e rezervuar, ajo njihet për martesën e lumtur që ka me biznesmenin Adrian, me të cilin ka dy fëmijë së bashku. Ai ka qenë shtylla edhe e nisjes së këtij hapi ku Alketa ka zgjedhur të jetë organizatorja e eventeve të njohura të vip-ave dhe më gjerë duke përfshirë këtu dasma, ditëlindje, festa beqarie etj. Ndër të fundit që Alketa me stafin e saj organizoi ishin dasma e Marinës me Getoarin dhe festa e beqarisë e Xhensila Myrtezajt.

ZAIMINA VASJARI

Seksbomba brune, pas një shkëputjeje nga bota e muzikës, vendosi të hapë një dyqan me veshje klasi dhe provokuese në emër të saj. Pas një bashkëjetese prej 12 vitesh me biznesmenin e njohur Klodian Asllani, ajo arriti që falë mbështetjes së tij të ndërmarrë hapin e hyrjes në biznes. Zai ka spikatur për stilin e saj ekstravagant në daljet e shumta në skenë, të cilat zgjodhi t'i kishte pjesë të butikut të saj tepër të suksesshëm. Edhe pse në pritje të ëmbël të një bebeje, ajo nuk nguron të pozojë sërish për të reklamuar veshjet nga dyqani i saj, dhe mund të themi pa dyshim se është një mami superseksi.

AMARDA TOSKA

Një tjetër bukuroshe e ekranit, e cila preferoi të zgjedhë të shkëlqejë në botën e biznesit. Padyshim në ndihmë, ish-moderatores së "Portokalli", i ka ardhur edhe bashkëshorti i saj, Ermal Mamaqi. Së bashku, nën emrin e saj, kanë një biznes eventesh dasmash e organizimesh të tjera festive. Nuk kemi se si të mos përmendim konkurrencën me bizneset e tjera, por që, gjithsesi, arrin në mënyrë të mrekullueshme, falë edhe reklamave të shumta, të ketë sukses në rrugën e zgjedhur.

ANDRRA DESTANI

Bashkëshortja bukuroshe e Sinan Hoxhës është më e reja, e cila do të nisë rrugëtimin e saj në botën e biznesit. Vetëm sot ka dalë lajmi se bëhet fjalë për një butik që sipas burimeve investimi ka qenë i madh, afërsisht 600 mijë euro. Duket se dashuria e këngëtarit të njohur për nusen e tij nuk paska fund dhe për t'ia bërë akoma më të dukshme, përveç surprizave të shumta, ka zgjedhur të investojë edhe këtë shumë marramendëse. Bukuroshja Andrra njihet për stilin e saj në të veshur dhe nuk e vëmë aspak në dyshim se edhe butiku, i cili pritet të hapet së shpejti, do të ketë shumë stil dhe elegancë.

AURELA GAÇE

Nuk kishim se si të mos përmendim edhe këngëtarën superbombë si nga zëri edhe nga karakteri, Aurela Gaçen. Ajo, edhe më parë ka spikatur për zërin e saj bombastik, dhe për energjinë e pashteruar që sjell shumë pozitivitet te kushdo që e dëgjon. Që pas kthimit nga Amerika, për të qëndruar këtu në vendlindje, Gaçe zgjodhi që zërin e saj ta bëjë akoma edhe më të famshme. Nuk diskutohet që energjia e saj i ka dhënë krahë biznesit të hapur së bashku, po kudo që është ajo bëhet zhurmë dhe ka gëzim.

XHEMI SHEHU

Bukuroshja bionde, Xhemi nuk ka preferuar të flasë shpesh për jetën e saj private, kjo vihet re edhe në rrjetet sociale që ajo ka ku mungojnë foto familjare. Përveçse është moderatorja seksi dhe aktorja e puntatave gazmore në "Portokalli", Xhemi ka edhe një biznes privat të saj. Fatlumi, i cili ka arritur të rrëmbëjë zemrën e bukuroshes është Ervin Sula, administratori i një shtypshkronje në Tiranë. Padyshim që ai ka preferuar që t'i japë mundësinë bashkëshortes së tij të ketë jo vetëm ngrohtësinë familjare, por, gjithashtu, edhe suksesin në biznes. Aktualisht Xhemi ka një SPA të sajën nga ku bën shpesh edhe reklamime nëpërmjet statuseve në rrjetet e saj sociale.



Dokumentet duhet të dorëzohen brenda tre muajve për këstin e dytë

Ish-të përndjekurit, 3000 trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblim

Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve të plotësojnë dosjet

Ornela Manjani

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë jo parësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë jo parësore, për trashëgimtarët, rreth 3000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjen me dokumente. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë, së bashku me analizën e dokumentacionit për çdo dosje, për përfituesit e kështit të dytë. Dokumentet për trajtimin me dëmshpërblim pas shqyrtimit të juristit, duhet të dorëzohen brenda tre muajve.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi

ndryshim të identitetit, Emër/Mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medomos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë

që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe

rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërtetohet vëkjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt

vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", - thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

TRASHËGIMTARËT PËR KËSTIN E DYTË

(Vijon nga numri i djeshëm)

NR. DOSJES	ISHI DITË/JARI POLITIK			TRASHËGIMTARËT E NIVELIT I			TRASHËGIMTARËT E NIVELIT II			DOKUMENTAT						
	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGJIT FAMILIAR	DESIMI TRASHGIMIE	PROKURE	
13486	HYSEN	BRISKU		RAPUSH HYSEN			BRISKU			V	V	V	V	V		
				NEZIR ZYRA			BRISKU(SULKA)			V	V	V	V	V		
				MEHMET HAZIS			SULKA			X	X				P	
				TEREZA ANDREA			SULKA			V					P	
				MINUSHE RAMADAN			SULKA			X					P	
				HYSEN SHADAN			BRISKU			V	V	V	V	V		
				SHADAN RAMADAN			BRISKU			V	V	V	V	V		
				FIZE ISMAIL			BRISKU			X	X				P	
				GANI			BRISKU			X	X				P	
				BRILZHDI RAMADAN			BRISKU			V	V	V	V	V		
				RAMIS BASHKIM			BRISKU			X	X				P	
							BRISKU			V	V	V	V	V		
9320	Khezo	Dosti	509	Hyeni						V	V	V	V	V		
				Hyeni Tahir			Dosti			V	V	V	V	V		
				Sado Abbas			Dosti			V	V	V	V	V		
				Tahir Hyeni			Dosti			X	X				P	
				Guce Hyeni			Dosti			V	V	V	V	V		
				Rubije Ali			Guce			Pashollari	V				P	
				Shpresa Evgjani			Guce			Bogju	V				P	
				Petro Arben			Guce			Muratdhi	V				P	
				Gentiana Vesel			Guce			Qirici	V	V	V	V		
				Hyeni Vesel			Dosti			Manni (D)	V				P	
				Mullarrem Vesel			Dosti			V	V	V	V	V	P1	
				Maria Vesel			Dosti			Dobri	V				V1	
				Anila Vesel			Kamari (E)			V	V	V	V	V	P1 X Prokura	
1688	Sulo	Konjari	691	Idriz						V	V	V	V	V		
				Manushaq Refat			Konjari			V	V	V	V	V		
				Besnik Sulo			Konjari			V	V				P	
				Ibrahim Sulo			Konjari			V	V				P	
				Lumburije Sulo			Bahma			V	V				P	
				Wilhelm Sulo			Konjari			V	V				V	
				Mirinda Mifinda			Wilhelm Suleta			V					P X Prokura	
				Suleta			Wilhelm Konjari			V	V	V	V	V	P X Prokura	
				Artiana			Mbymer Konjari			V	V				V	
7394	ZEF	KOLA	363	GJIN						V	V	V	V	V		
				DRANE PRAN			ZEF KOLA			V	V	V	V	V	P	
				MARIN MARK			ZEF KOLA			V	V	V	V	V	P	
				NIKOLL ZEF			KOLA			V	V	V	V	V	P	
				ZEFERIN ZEF			KOLA			V	V	V	V	V	P	
				ZEF ZEF			KOLA			V	V	V	V	V	P	
3801	KICI	THANARAN	1015	PROFI NUAUNKE			PROFI BOCI			V	V	V	V	V		
				Ndreu Nikolla			Jorgji Boci			V					P1	
				Sokrat			Jorgji Boci			V	V				V1	
				Uani			Profi Thanaraku			V	V	V	V	V	P	
				ASPRUE THEME			UANI HILA			X					P	
				JORGJIE MARIJE			UANI THANARAN			V	V				P	
				MARIE SKE			UANI MEHILLI			V					P	
				LIFE DALINE			UANI JANI(Thar)V			V					P	
							Goga(Tha)V			V					P	

NR. DOSJES	ISHI DITË/JARI POLITIK			TRASHËGIMTARËT E NIVELIT I			TRASHËGIMTARËT E NIVELIT II			DOKUMENTAT						
	EMER	MBIEMER	VKM NR.	EMER	ATESIA	MBIEMER	EMER	ATESIA	MBIEMER	KOPJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIBANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRINGJIT FAMILIAR	DESIMI TRASHGIMIE	PROKURE	
19571	BAIRAM	MAJMI	61	SAFET			SADIK BENDAJ							V	V	
				VELI RAMADAN			BENDAJ			V	V					
45182	BLIJAR	SKENDERI	1009	LORENÇ SPARTAK			BLIJAR SKENDERI			V	X	X			P X Prokura qe Lorig	
				NAILE QUAZIM			HYKA			V	V				V X Prokura qe Lorig	
12560	Hevzi	Nela	1069	Ajllan Shaban			Nela			V	X	V	V	V		
				Shaban Sale			Shaban Nela			V	V				V	
				Iliaz Kamille			Kasem Dafku									
				Alije Kurtish			Kasem Dafku									
				Arif Nazamije			Kasem Dafku			V	V				V	
				Zeynep Zejnepe			Kasem Alajj (Dafku)			V	V					
				Refije			Shaban Nela			V	V					
21376	Fetah	Lazimi	509	Meksut Fetah			Lazimi			V	V	V	V	V		
				Mimroza Edip			Meksut Drunga			V	V					
				Refiko Fetah			Laknori			V	V	V	V	V		
				Marjolpa Fatmira			Fetah Lazimi			V	V	V	V	V		
				Mimroza Edip			Meksut Drunga			V	V					
				Etielva Marjolpa			Idriz Shireta			V	V					
				Marjolpa			Idriz Shireta			V	V					
11547	Kudret	Kurti	707	Nimete Avdurram			Kurti			V	V	V	V	V		
				Ilir Kudret			Kurti			V	V				P	
				Servete Vesel			Kurti (Derrin)			V	V				P	
							Kurti			V	V				V	
14666	HAXHI	MUÇAJ	497	RIJKE BEJAZE			SHABAN MUÇAJ			V	V	V	V	V		
				SKENDER RIZA			HAXHI MUÇAJ			V	V				P	
				QANI BEÇIR			HAXHI MUÇAJ			V	V				P	
16940	Ibrahim	Zhullima	509	Zelie Sherif			Enrullah Zhullima			V	V	V	V	V		
				Petrif Ibrahim			Domanaj (Zhullima)			V	V					
							Ibrahim Zhullima			V	V					
21555	Mustafa	Dallashi	509	Lije Sultane			Like Mustafa			V	V	V	V	V		
				Bogjije Sheku			Hyen Tufa			V	V					
				Fatmir Caje			Mustafa Tatili			V	V					
				Gezim			Mustafa Dallashi			V	V					
				Mimroza Valbona			Gezim Dallashi			V	V				P	
				Fitetete Gani			Dallashi			V	V				P	

(Vijon nesër)

Dje në "Zëri i Amerikës"

Serbia ngul këmbë në politikën e "dy karrigeve"

(Vijon nga faqja e parë)

... në një intervistë me agjencinë e lajmeve "Reuters", ritheksoi këtë qëndrim duke iu referuar deklaratave të diplomatit amerikan Hoyt Brian Yee, i cili paralajmëroi Beogradin "se nuk mund të qëndrojë i ulur në dy karrige".

"Kur dikush na kërkon të mos ulemi në dy karrige, atëherë ai po përpjetet në na heqë karrigen... që ne të rrëzohemi. Për këtë arsye mendoj se nuk duhet t'i kushtojmë vëmendje kësaj kritike. Është me rëndësi që t'i përmbahemi interesit tonë kombëtar", tha ai.

Shumë serbë e shohin veten viktimë të bombardimeve të NATO-s në vitin 1999 që çuan në çlirimin e Kosovës, ndërsa Beogradi vazhdon të ruajë lidhjet emocionale e kulturore me Moskën, posaçërisht edhe për shkak të qëndrimit të saj kundër pavarësisë së Kosovës që u shpall në shkurt të vitit 2008, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara dhe vendeve kryesore të Bashkimit Evropian.

Ditë më parë, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, tha se me diplomatit amerikan Hoyt Brian Yee kishte zhvilluar një takim "jo të këndshëm", ku temat kryesore ishin Kosova dhe Rusia.

"Ai (Hoyt Brian Yee) më tha se nuk mund të preknim tërësinë tokësore të Kosovës, ndërsa unë i thashë se ju keni mundur të preknim tërësinë e Serbisë nëntë vjet më parë. Atëherë vlenin rregulla të tjera. Këtë ia thashë në fytyrë. Ai mua ma bëri të ditur, tha: Të kam përcjellë mesazhin e Amerikës. Duhet ta respektosh, nëse nuk e bën... dihen pasojat...", tha presidenti serb.

Ndërsa ministri i Jashtëm serb duke i bërë një krahasim çështjes së Kosovës dhe asaj të Katalonjës në Spanjë, tha se "Nëse Spanja mund të luftojë për konceptin e saj, atëherë edhe serbët mund të luftojnë për vendin e tyre".

Derisa synon integrimin në Bashkimin Evropian, Serbia ka refuzuar t'u bashkohet sanksioneve euro-amerikane kundër Moskës



për shkak të veprimeve të saj në Ukrainë.

Zyrtarë të Ministrisë së Jashtme të Serbisë madje paralajmëruan masa ndaj ambasadorit ukrainas në Beograd, Olexsandr Aleksandrovich, i cili në një intervistë me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuose, tha se "Rusia po e shfrytëzon Serbinë për të destabilizuar Ballkanin dhe për të shkatërruar Evropën".

Zhvillimet politike në Evropën Juglindore gjatë vitit të fundit

next-itën shqetësime në rritje për paqëndrueshmërinë e rajonit dhe ndërhyrjen e Rusisë, e cila nuk i sheh më sy të mirë integrimet euroatlantike të vendeve të Ballkanit. Shtetet e Bashkuara kanë shprehur shqetësim edhe për një qëndër të emergjencave që Rusia

menaxhon në qytetin e Nishit në Serbinë jugore. Disa grupe perëndimore dhe analistë ushtarakë e shohin si një bazë ushtarake të kamuflluar që Kremlinin e ka ngriitur për të mbikëqyruar interesat amerikane në Ballkan.

Qendra ruse që u hap fillimisht në vitin 2012, gjendet relativisht pranë forcës paqeruajtëse prej 4 mijë trupash në Kosovë. Pjesë e forcave ndërkombëtare në Kosovë janë edhe 600 ushtarë amerikanë.

Moska kërkon që personelit të saj t'i jepet imunitet diplomatik, ndërsa mohon çfarëdo veprimtarie të saj përveç trajtimit të emergjencave. Ajo i dorëzoi ditë më parë gjashtë avionë ushtarakë MiG-29 Serbisë, ndërsa pritet që të dërgojë në Beograd edhe 30 tanke T-72 dhe 30 automjete të blinduara.

Megjithatë Beogradi është përfshirë në një proces bisedimesh për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën në shkëmbim të afrimit më strukturat evropiane.

Në fillim të kësaj jave Serbia edhe zyrtarisht hapi dialogun e brendshëm për çështjen e Kosovës në kërkim të, siç thuhet, "një marrëveshjeje historike me shqiptarët".

Hapja e këtij dialogu të nisur nga presidenti serb Aleksandër Vuçiç, nxiti shumë reagime në Serbi ku janë hedhur edhe ide për ndarjen e Kosovës, ide këto që janë hedhur poshtë nga Prishtina.

Te gjitha te rejat nga jefa ipave

e V ipave

çdo të shtunë falas me GAZETA SHQIPTARE

BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

Opinioni *i* Ditës

Nga Enver Bytyçi

Pyetje 'idiote' apo përgjigje idiote?

(Vijon nga faqja e parë)

... interpretohet "si dashuri" midis palëve, ndërkohë që nëse paraardhësi i Ramës do të ndërtonte të njëjtin qëndrim, do të interpretohej si "diktaturë".

Aftësia e amplifikimit të metaforave nga kryeministri dhe zëdhënësit e tij të paguar në dorë e nën dorë është shndërruar tashmë në një rrezik serioz për lirinë e qytetarëve shqiptarë, jo vetëm të gazetarisë dhe medias së lirë në Shqipëri! Sipas kryeministrit dhe "vampirëve" rreth tij me metastaza kanceroze, gazetarët "janë idiotë", sepse "bëjnë pyetje idiote". Zëdhënësit e Ramës e mbrojnë fort këtë tezë, duke i dhënë një dorë instalimit në Shqipëri të një diktature të maskuar, duke fajësuar median për raport jo të drejtë me të vërtetën, ndërkohë që mijëra fakte provojnë se është kryeministri ai që fsheh të vërtetat, të cilave media dëshiron t'u shkojë deri në fund.

Por, para se të shprehem për rrezikun e raporteve agresive të kryeministrit, do të më duhet të shpjegoj raportin midis "pyetjes idiote" dhe "përgjigjeve idiote"! Afër tetë vite kam jetuar në Gjermani në kontakt me dijen, në institute, universitete, biblioteka dhe institucionet e administratës gjermane. Sa herë kam hezituar të bëj pyetje, bashkëbiseduesit më thoshin: "Pyet për gjithçka, sepse nuk ka pyetje idiote, por ka përgjigje idiote"! Aq shumë është artikullar kjo këshillë prej xhentlemësh nga ata me të cilët kisha kontakt në Gjermani, sa këtë ua përsëris si idiomë vazhdimisht studentëve të mi. Por, kjo është kultura gjermane e po ashtu evropiane e perëndimore.

Ndërsa kryeministri ynë hapur dhe në publik u thotë gazetarëve se, "ju bëni pyetje idiote"! Ndërkohë, megafonët e tij në debate televizive e mbrojnë këtë tezë me ngulm, pa menduar ky qëndrim ka të bëjë me mentalitetin ballkanas, i cili është larg së qeni një mentalitet perëndimor.

Dukej se historia e pyetjeve "idiote" ishte harruar në skutat e diktaturës, kur gazetarët dhe njerëzit në përgjithësi kishin frikë të pyesnin, se mos hamendësohej ndonjë kundërvënje ndaj vijës së partisë. Kjo histori u rikthye tani dhe unë e shoh si përpjekje për të restauruar të njëjtin psikologji frikësuese të gazetarët e të njerëzit e thjeshtë, me qëllim konstrukturimin e një vije të caktuar, e cila

buron nga një lider, tek i cili gjithkush e për gjithçka do të duhej të kishte besim të padiskutueshëm! Në ndihmë të kësaj ideje vijnë shumica e botuesve të blerë të mediave në vend, në veçanti mercenarët në të dyja anët e kufirit shqiptaro-shqiptar, të cilët kurrë nuk u kanë munguar perandorive dhe diktaturave.

nëpërmjet saj edhe opinionin publik, aq sa ka filluar të qarkullojë ideja idiote dhe e rrezikshme se "Krimi, trafiket, droga sjellin zhvillim"! Ky është një akt më i tmerrshëm se sundimi i një diktature, e cila si e tillë ushtron pushtet absolut përmes disa ligjeve dhe rregullave, të cilat së paku publiku i njeh. Krimi i mbjellë në shtet e

Kryeministri, në vend të nxirrte një ligj për mbrojtjen e gazetarëve nga botuesit e pronarët, së paku që t'u sigurohet atyre një pagë e merituar si dhe garancia sociale e shlyerjes së detyrimeve për të si dhe siguria e kontratës së punës, i shtyn ata drejt pasigurisë së mëtejshme.

Dhe në fund, nëse halli i një dik-



Edi Rama me një gur po "vret" shumë zogj! Kryesore për të është të largojë vëmendjen nga kriminalizimi që ai i ka bërë partisë së tij, politikës shqiptare, institucioneve të vendit dhe segmenteve të caktuara të shoqërisë shqiptare. Me këtë frymë kriminalizimi po mëkon median në Shqipëri e

nëse shtrihet në shoqërinë tonë, nuk ka rregulla, ka vetëm viktima. Nga ana tjetër, kryeministri e di se sulmet ndaj gazetarëve ndikojnë të ringjallet fryma e autocensurës. Në rastin konkret një autocensurë e motivuar nga frika e "idiotizmit pyetës", por edhe nga frika e pronarëve të medias ku ata punojnë.

tatori është ruajtja e pushtetit duke eliminuar kundërshtarët e tij, halli i një të inkrimiuari si kryeministri ynë është i dyfishtë: - Si të eliminojë kundërshtarët, kryesisht si të paralizojë median dhe si t'i rezistojë të procesit larges së hesapeve nga ana e bandave, pjesë e të cilave është ai vetë.

HOROSKOPI

DASHI

Është koha e përshtatshme për të kërkuar një ngritje në detyrë, ose për të fituar një vend pune që kërkoni seriozitet dhe aftësi. Një vendim i papritur do të dalë se është i duhuri kundër çdo parashikimi pesimist. Provojeni!

DEMI

Jeni shpërndarë në shumë fusha. Ndiqni objektiva që ju lodhin dhe ju stresojnë. Mos vallë për hir të kësaj keni lënë mënjanë dashurinë? Dashira dhe pasioni do të bëjnë që të kërkontë mundësi për të biseduar dhe bashkëpunuar me partnerin.

BINJAKET

Sot priten ulje dhe ngritje të humorit në lidhje me sgarime familjare, por jo përballje zënkash. Çirohuni nga të tjerët. Veproni sipas mendjes tuaj në çdo mjedis, po u dashur fare t'i përshatëni rritmeve të tjerëve.

GAFORJA

Keni mundësinë për të takuar persona dhe kultura të ndryshme nga e juaja, me tradita dhe mënyra të tjera jetese. Parashikohen udhëtime. Zgjidhni angazhimet! Pas pak do t'ju duhet të hiqni dorë nga orët e gjumit për të mbajtur ritmet e veprimtarisë!

LUANI

Një epror do që t'ju besojë një detyrë delikate dhe të rëndësishme. Tashmë e di që jeni disi kryelartë, por askush nuk e ka aftësinë e juaj! Urani dhe Saturni ju favorizojnë në veçanti të gjitha veprimtaritë e juaja artistike dhe krijuese.

VIRGJERESHA

Një realizëm i mirëfillt dhe një sens praktik do të jenë zgjedhja e duhur për të luftuar rastësitë jo të favorshme që do t'ju dalin për të përballuar. Me Merkuri që nuk ju mbështet, do të keni pirje të gjykonit të tjerët edhe për gjëra të kota: përpikuni të jeni më realistë.

PESHORJA

Nuk mund të mohoni më faktet. Duke parë që një ngjarje e vjetër shfaqet vazhdimisht, më mirë të përballeni njërherë e për gjithmonë, për ta lënë pas. Do të jeni të disponueshëm dhe me humor të mirë. Do të shijoni anën e këndshme të dashurisë.

AKREPI

Nuk do të humbni vëmendjen nga interesi e juaja për të vrapuar pas angazhimeve të përditshme dhe çështjeve praktike. Keni nevojë për lëvizje, për ajër të freskët dhe të pastër për t'u mbushur me frymë. Organizoni një udhëtim në një zonë detare.

SHIGJETARI

Sot marrëdhëniet tuaja do të jenë më të fuqishme. Mund të ndryshoni mendje për një eveniment. Do të keni takime të mrekullueshme që do t'ju ndryshojnë jetën e dashurisë apo do të forcojnë lidhjet ekzistuese.

BRICJAPI

Do t'ju duhet të merrni disa vendime të vështira për të çuar përpara gjërat. Prandaj, nuk ju qelet gjë tjetër, përveçse të angazhoheni! Tregohuni të vëmendshëm ndaj kritikave të një mikru, për të bënë krah për përshlyesjen kanë të tjerët për ju.

UJORI

Të papritura të këndshme në familje. Përditshmëria do të jetë më emocionuese dhe e këndshme, edhe pse do t'ju ndodhë që të ndryshoni menjëherë programin. Do të jeni në lartësinë e duhur për të marrë vendime shumë delikate. Do të fitoni këshull vlerësimin e një eprori.

PESHQIT

Keni shumë pritshmëri ndaj një personi që ndoshta nuk do të tregohet në lartësinë e duhur. Do të ishte më mirë të përqendroni vëmendjen diku tjetër. Mos u bëni kokëfortë! Keni dëshirë të madhe të imponoheni në të gjitha rrethanat. Do të ishte mirë që edhe të mendoheshit pak për veprimet që ndërmerri.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Trajneri i Kombëtares së Shqipërisë Kristian Panuçi bëri publike listën me 25 lojtarët që do të grumbullojë për ndeshjen miqësore kundër Turqisë më 13 nëntor. Dy risi, rikthime, por edhe zgjedhje të çuditshme në listën e teknikut. Panuçi ka konfirmuar zërat që qarkullojnë javët e fundit, duke i dërguar ftesë mesfushorit të AEK-ut të Athinës, Astri Ajdareviç, Futbollisti i lindur në Prishtinë, por i rritur në Suedi, u bashkohet prurjeve të reja bashkë me Ylber Ra-

Por gjen një vend Aliji, që është pa klub!

Panuçi fton Ramadanin dhe Ajdareviçin, jashtë Cikalleshi e Balaj

madanin. Ish-mesfushori i Partizanit, tashmë pjesë e Veljes në kampionatin danez, është prej kohësh pjesë e skuadrave zinxhir kuqezi, por ky është grumbullimi i parë me kombëtares e parë. Pas një mungese të gjatë në kombëtare kthehet edhe mesfushori i Skënderbeut Sabien

Lilaj. Futbollisti korçar ka bindur Panuçin me formën e shkëlqyer në këtë sezon dhe bashkë me portierin e Partizanit, Alban Hoxha janë dy lojtarët e vetëm nga Superliga. Për miqësoren kundër Turqisë nuk do të jetë i grumbulluar Ergys Kaçe dhe Memolla, por dyshimet më të

mëdha janë të lënia sërish jashtë kombëtares se sulmuesve Bekim Balaj dhe Sokol Cikalleshi. Dy sulmuesit nuk po kalojnë një periudhë të mirë. Ky mund të jetë një justifikim, por sigurisht që nuk mban nëse sheh që Panuçi ka grumbulluar Naser Alijin pa një klub, siç



theksohet edhe në listën e publikuar nga Federata. Për miqësoren kundër Turqisë, Panuçi ka preferuar të

grumbullojë kombëtares ditën e hënë në Antalia ku dhe do të luhet sfida në datën 13 nëntor.

Përfliten emra nga politika si kundërshtarë. Presidenti aktual kërkon të fitojë kohë

Armand Duka: Nuk e di në do të rikandidoj

Kreu i FSHF-së është i dyzuar për të ardhmen e tij



Jeton Selimi

Aka frikë Armand Duka? Kjo është pyetja që shumica e protagonistëve të futbollit shqiptar, por edhe mediet dhe futbolldashësit, po bëjnë në këto ditë nëntori, kur lufta për kreun e FSHF-së ka nisur më shpejt se kurrë. Në medie janë përmendur emra deputetësh si kandidatë të mundshëm kundër Dukës për zgjedhjet e marsit, ndërkohë që kritikant ndaj tij kanë shtuar ethet (sidomos nga Partizanit dhe Flamurtari). Presidenti aktual i FSHF-së, gjithsesi, nuk e jep veten. I stërvitur me pyetje dhe gazetarëve dhe presionin, në intervistën ekskluzive të dhënë për "Citynews" ai shprehet se sulme ka pasur, por jo me bazë të fortë. 55-vjeçari, i cili ka një dekadë e gjysmë që mban fronin (pa më të voglën metaforë) e futbollit shqiptar, praktikisht pranon se do të rikandidojë dhe se pret kritikë nga të gjitha palët. Ai flet edhe për trajnerin Kristian Panuçi, çështjen e gjyqtarit Lorenc Jemini dhe jep argumentet kryesore në favor të tij para zgjedhjeve të marsit.

Rezultatet e Kombëtares me Kristian Panuçin nuk kanë qenë pozitive në Eliminatore, por tashmë po vjen miqësorja me Turqinë. A jeni i bindur nga afërsitë e tij?

Për trajnerin jam shprehur edhe në bilancin e Eliminatoreve në një bisedë që zhvilluam me mediet. Them se në katër ndeshjet me të në stol skuadra më ka bindur dhe jam i kënaqur. Madje, në ato katër ndeshje meritonim ndonjë pikë më shumë.

Thuhet se e keni zgjedhur vetëm se nuk ka kërkuar pagë të lartë.

Jo, nuk ekziston aspak çështja financiare. Mua më bindi grinta e tij për të kthyer nërin e skuadrës së Evropianit, që kishte vdekur pas paraqitjes sonë në fazën finale të "Euro 2016"-s.

Po për gjyqtarin Lorenc Jemini, ç'mund të na thonit? Ai pretendon se kurrë nuk mori një përgjigje zyrtare për largimin e tij dhe tani është dorëzuar. Si qëndron



e vërteta?

Për Jeminin mendoj se sektorët përkatës kanë komunikimet e tyre me gjyqtarët dhe jo vetëm me Jeminin. Në rastin konkret, ai ka qenë i pezulluar nga komisionet në pritje të një vendimi tjetër. Një çështje e tillë nuk e di pse ka marrë një kamufllim kaq të

madh mediatik.

Kalohet te tema më e rëndësishme e këtyre javëve, zgjedhjet për kreun e FSHF-së. A do të rikandidoni në mars?

Kjo është një pyetje që i përket mbase një momenti tjetër. Duhet të kem kontaktet me komunitetin e futbol-

lit, anëtarët dhe pastaj do të marr vendimin tim.

Dakord, por do të doja një përgjigje më të prerë.

Mendoj se në momentin më të përshtatshëm do të njiheni edhe me vendimin tim. Ju siguroj se do të bazohet tërësisht nga vullneti i anëtarëve për të vazhduar

bashkëpunimin e mëtejshëm.

Nuk po bëj "trimin", sidomos, sepse së fundmi jeni sulmuar më shumë se kurrë. Ndiheni nën presion?

Ju i quan sulme, por në shumicën e rasteve janë më shumë amplifikime pa një bazë të vërtetë. Në situata të tilla, në prag të vitit zgjedhor, e pranoj se nuk është se kanë munguar. Unë jam shumë i hapur për çdo kritikë të shëndoshë në aspekt të punës së FSHF-së, madje çdo gjë e tillë është produkt i një analize të mëtejshme.

A druheni se do të ndërhyjë politika, siç ka ndodhur edhe më përpara? Përfliten dy deputetë si kandidatë kundër jush.

Jam i prirur të besoj se politika do të vazhdojë të jetë pranë futbollit në aspektin e investimeve, por edhe atë të mbështetjes ligjore. Për çdo emër që del dhe që kërkon të garojë, edhe pse jemi ende herët dhe asgjë nuk është zyrtare, çdo gjë është e lirë dhe FSHF-ja do të respektojë kandidaturën e gjithkujt që kërkon të japë kontributin e tij.

Konfirmimin për rikandidimin e dhatë. Me çfarë argumentesh e mbron veten për zgjedhjet?

Për zhvillimin e futbollit shqiptar argumentet janë të shumta dhe po ju përmend këto: Kamza-Partizani 14:00, Teuta-Laçi 17:00. Të Dielën Skënderbeu-Vllaznia 14:00, Flamurtari-Kukësi 17:00.

FSHF bën 'çorap' kalendarin Vllaznia-Skënderbeu do të luhet në... Korçë!



SUPERLIGA	
JAVA E 9	
TË SHTUNËN	
Luftëtari-Lushnja	14:00
Kamza-Partizani	14:00
Teuta-Laçi	17:00
TË DIEËN	
Skënderbeu-Vllaznia	14:00
Flamurtari-Kukësi	17:00


në garën e klubeve kryesuese, teksa shumë mirë ndeshja mund të luhet me Vllaznimë si pritëse në një stadium tjetër.



Partizani, Juliano kundër Moxhit për titullin: Mua më takon të rikthej lojën dhe rezultatet

Seria e fitoreve të Partizanit u ndal nga Flamurtari, që ia doli të merret tre pikë në "Selman Stërmasi" javën e shkuar, gjë që ka sjellë zhgënjim në kampin e kuq. Dicka të tillë e pranoi edhe trajneri Mark Juliano sot në konferencë për shtyp, teksa fillimisht deklaroi: "Është një situatë e vështirë. Ishim në rritje pas tre fitoreve rresht, por ndeshja me Flamurtarin ishte zhgënjyese në aspektin e rezulttit". Për trajnerin italian tashmë është koha për të reaguar, ndërkohë që thekson se nuk është i shqetësuar: "Lojtarët janë të vetëdijshëm se ishte një humbje e rëndë, por duhet të marrim të gjithë përgjegjësitë dhe duhet të rikthehemi te rezultatet pozitive. Jemi në një moment ku duhet të tregojmë se mund të arrijmë rezultate të mira. Nuk jam i shqetësuar, edhe pse më vjen keq për lojtarët dhe tifozët dhe e di se duhet të punojmë më shumë. Nuk me trembin kritikant, përgjigjet pres t'i japim më fushën e lojës". Moxhi ditë më parë foli për problemet në sulm dhe në të njëjtën linjë është edhe Juliano: "Çdo javë jemi në vëzhgim dhe fjalët e Moxhit janë normale. Duhet të përmirësohemi në finalizim, ku kemi edhe pikën tonë me të dobët. E dimë që duhet të bëjmë më mirë, edhe pse ndonjëherë është e vështirë, sepse krijon shumë dhe nuk arrin të fitosh". "Titulli i kampionit? Jam dhe nuk jam dakord me Moxhin për çështjen e titullit. Puna ime është të rikthej rezultatet dhe lojën e bukur. Kryesore për mua është ta çoj skuadrën në një nivel të lartë. Mua më takon vetëm të punoj dhe jo të flas.

Fjalëkryqi (1)




- HORIZONTAL**
 1. Gjysmë arkivi.
 4. Sikur janë në krye.
 6. Janë të drejtë në skuadër.
 11. Një mund të jetë diplomatik.
 13. Ndërmarrje Montirimi Kombëtare.
 16. Shikon kot në veshetë.
 17. Janë gazetatat si RD e ZP.
 21. Inicialet e Morricono-s.
 22. Shkroi Në kërkim të kohës së humbur.
 25. Pastaj në fund.
 26. Brody i Pianisti.
 27. Fillojnë një rubrikë.
 29. Skuadra merengue.
 31. Gjysma e mollës.
 32. Baudo anchorman.
 34. Eshhtë honi.
 35. Mbyllin shishe.
 36. Një dylufitim.
 37. Ishte lumi i harresës.
 39. Ishte xhelozja e Olimpiti.
 40. Lutje pa cifte

- VERTIKAL**
 1. Ai dhe ajo.
 2. Në hyrje të rrethit.
 3. Eshhtë trofe që fitohet.
 5. Një derby i Madonnina-s.
 7. Ndreç në kufij.
 8. Mbyllin kënde.
 9. Mund të jenë gjaku dhe kuzhine.
 10. Royh aktor
 12. Janë klasat që nuk takohen.
 14. Janë pasanikë.
 15. Munë të jenë republike.
 18. Rajone Civile Durrës.
 19. Kuron pa zë.
 20. Diftong në teori.
 22. Kur bie... nuk të le të shohësh.
 23. NJë personazh i Dickens.
 24. Kompozoi Boccaccio.
 25. Të fundit në ditar.
 28. Studion bimët dhe lulet.
 30. Franklin që qe këngëtare.
 32. Kufizojnë paktet.
 33. Qytet italian.
 38. Nuk ka shenjtore në desk top
 43. Stacion televiziv gjerman.
 45. Besim pa kufij.
 46. Ajri i Londrës.
 47. Loja me games.
 50. Fillojnë detyrën.
 52. Inicialet e Altman.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
 1. Jo të gjitha bëjnë mjalte.
 6. Janë skuadra.
 12. Janë principe
 14. Një pije freskuese.
 15. Ashtu qoftë në kishë
 16. Mund të jetë një mbrëmje letrare.
 19. Gjysma e kishës.
 20. Janë europianët e BE.
 22. Diftong në teatër.
 23. I 42 ai i Dos Passos
 24. Inicialet e Presley.
 25. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
 26. Mbyllin fushatat.
 27. Fillojnë një metodë.
 29. Ende është ndryshe.
 31. Mund të jenë 4 X 100 dhe 4 X 400.
 33. Një gjuhë që flitet edhe në Sri Lanka.
 34. Kshutu thirrje Marco Pantani.
 35. Eshhtë faqe ene.

- VERTIKAL**
 1. Pret shumë fëmijë.
 2. Opera e Mascagni-t.
 3. Zyrë Informatoni Ndërkombëtare
 4. Tamam në fund
 5. Një dhjetë në vit
 7. Eshhtë i pashpirti.
 8. I bën edhe Agron Llakaj.
 9. Mbyll fjalinë
 10. Si e gjithë.
 11. Fillojnë tatëpjetën.
 12. Mund të jenë cigaresh.
 13. Jepet për hartim.
 17. Ka një prind me ngjyrë.
 18. Janë vendet aderuese.
 20. Ndërohen me zapping.
 21. Eshhtë nofkë
 23. Eshhtë "Catia e botës"
 25. Mund të jenë zemërkau.
 28. Eshhtë hidrokarbur.
 30. Eshhtë kreu i bandës.
 31. Futen në prizë.
 32. Eshhtë vija e portës.
 36. Janë llojet e njerëzve.
 39. Si moral
 40. Ka dy bigami.
 43. Fillojnë daljen.
 45. Sikur janë në krye.
 47. Inicialet e Klee piktor.




- VERTIKAL**
 1. Pret shumë fëmijë.
 2. Opera e Mascagni-t.
 3. Zyrë Informatoni Ndërkombëtare
 4. Tamam në fund
 5. Një dhjetë në vit
 7. Eshhtë i pashpirti.
 8. I bën edhe Agron Llakaj.
 9. Mbyll fjalinë
 10. Si e gjithë.
 11. Fillojnë tatëpjetën.
 12. Mund të jenë cigaresh.
 13. Jepet për hartim.
 17. Ka një prind me ngjyrë.
 18. Janë vendet aderuese.
 20. Ndërohen me zapping.
 21. Eshhtë nofkë
 23. Eshhtë "Catia e botës"
 25. Mund të jenë zemërkau.
 28. Eshhtë hidrokarbur.
 30. Eshhtë kreu i bandës.
 31. Futen në prizë.
 32. Eshhtë vija e portës.
 36. Janë llojet e njerëzve.
 39. Si moral
 40. Ka dy bigami.
 43. Fillojnë daljen.
 45. Sikur janë në krye.
 47. Inicialet e Klee piktor.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		6				1		2
9			3		5			7
		8	4	2	7			5
				8	2		5	1
		3		5		6		9
		5	7		4	3		
7				9	4	3	8	
6			1		8			9
8		1				4		

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	4	1	3	9	5	2	8	7
9	5	7	8	2	6	3	1	4
3	2	8	7	1	4	6	9	5
2	8	9	5	7	1	4	6	3
1	3	4	2	6	8	7	5	9
5	7	6	9	4	3	1	2	8
4	9	5	6	3	2	8	7	1
7	6	3	1	8	9	5	4	2
8	1	2	4	5	7	9	3	6

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Zhurma nuk provon asgjë. Shpesh një pulë që ka bërë thjesht një vezë, kakarrit sikur ka bërë një asteroid. (Mark Tuein)
- Asnjëherë mos i mbaj sytë përdhe kur hedh hapin. Vetëm ai që mban sytë të fiksuar në horizontin e largët do të gjejë rrugën e duhur. (Dag Hamaskjold)
- Mos kini frikë të ndërmerri një hap të madh nëse është e nevojshme. Nuk mund ta kaloni humnerën me dy hapa të vegjël. (Dejvid Lloid)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

13	5	10	1	10	19	18	5	8	6	3	19
O	B	A	T								
13		13	3	2	4	3	2	4	5	3	
7	2	9	5	4	6	5	4	5	3		18
7	1	4	6	15	5	10	3	5	3		8
19	9	20	2	10	1	4		6	3	2	
1	11	6		17		2			1	10	15
8	13	1	6	1	9		3	5	10	13	2
3	6	10	7	2		6	2	4	6	2	10
18	10		4		5	13	6	14	6		11
12	2	14	2	3		2	11	6		10	5
6		8	14	1	3		17	2	20	5	3

H	I	J	A		K	S		S	T	O	L
A	N	E	T		D	A	F		H	L	T
B	A	T		H	E	R	E	T	I	K	E
I	T		H	O	N	O	R	A	R	I	T
T		K	A	P	I	T	A	L	I	S	T
O	A	L		K	R	A		T		R	L
R	E	A		I	O		S	J	I	A	E
E		S		N	A	T	O	T	I	F	
M	I	S		S	P	O	E	T		N	O
N	I	K		I	M		L	A	M	E	N
A	N	E		S	T	E	Z	I	S	T	R
T	A		B	A	R	A	K	A		I	T

- Mos u trego shumë i 'ndershmë' me të gjithë në këtë botë... Mos harro se pemët më të 'drejta' zgjidhen gjithmonë të parat për t'u 'prejë'..!
- Paratë mund të bëjnë një maskull të pasur... Por është edukata ajo e cila e bën Zotëri.
- Ne nuk jetojmë, thjesht shprehim të jetojmë, duke pritur gjithnjë lumturinë në të ardhmen, ndaj është e pashmangshme që s'do të jemi asnjëherë të lumtur. (Blez Paskal)

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)
 LUISA KOHA AD
 PORTA FATALE S
 ES A DELP RNTS
 NAIT FELIKANITSH
 NELESABOTIMETIT
 LAKONIKETVITIT
 MONOTONVETEM
 BOLEROTIBERTIKKE
 SITERIRIATA
 PIREATANAAD
 NATAMIAAPEL

FJALËKRYQI (2)
 ROWAN BAKALLER
 ABELP NATALIR
 SOEPIITETITRIO
 ARARITRITATITOM
 KIRNONTARETINA
 KIAMERIKANE
 EHPAMADSH
 KOLONAKRITCE
 TUNELEITEREROS
 ERNATITKESITTEP
 TATISARAHETEP
 ETJAKATEETI



www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

